


**DHUNA SEKSUALE DHE
NGACMIMI SEKSUAL:
NJË ANALIZË E SITUATËS**



Ky studim është realizuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) në kuadrin e programit “Mbrojtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze

“Ky material është plotësisht i financuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Sida nuk është domosdoshmërisht dakord me opinionin e shprehur.”

AUTORËT:

Elona Dhëmbo
Veronika Duci

KONTRIBUAN NË TË CJITHA FAZAT E STUDIMIT:

Ines Leskaj
Anita Lushi

PUNIMI GRAFIK DHE FAQOSJA:

Eduart Cani

@Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Referenca e botimit: *Dhëmbo E., Duci V., Dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual: Një analizë e situatës, AWEN, 2022*

MIRËNJOHJE

Mirënjohja e parë shkon për të gjitha ato vajza dhe gra, pjesë e këtij studimi ose jo, të cilat kanë gjetur forcën dhe kanë raportuar, denoncuar dhe ngritur zërin kundër ngacmimit dhe dhunës seksuale, duke ndarë historitë e tyre, me qëllimin parësor që kjo mos të ndodhë për vajza e gra të tjera. Këtu duhet të përmenden dhe burrat pjesëmarrës në fokus grupe, të cilët nuk kanë ngurruar të japin këndvështrimin e tyre për këtë fenomen dhe mënyrat sesi ata e shikojnë adresimin e tij.

Ky studim nuk do të ishte bërë i mundur pa lehtësimin dhe punën koordinuese të organizatave anëtare të Rrjetit AWEN: Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Vlorë; Forumi i Gruas, Elbasan; Organizata "Gruaja tek Gruaja", Shkodër; Qendra Agritra-Vizion, Peshkopi; Qendra Jona, Sarandë; Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë; Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë; Shoqata Gender, Paqe dhe Siguri, Durrës; Unë Gruaja, Pogradec; Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, të cilat kanë ndihmuar me procesin e identifikimit të të mbijetuarave të ngacmimit dhe dhunës seksuale dhe organizimin e intervistave me to. Mirënjohje shkon po ashtu për Qendrën për Advokim Social për kontributin e dhënë në këtë proces.

Falënderojmë Agjencinë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida për mbështetjen lidhur me zhvillimin e këtij studimi dhe mbështetjen e dhënë përgjatë viteve për shërbimet sociale të specializuara.

Falënderim i veçantë është për studiueset Elona Dhëmbo dhe Veronika Duci, të cilat kanë qenë të përkushtuara në realizimin e disa studimeve të ngjashme me AWEN, me qëllim rritjen e nivelit të informacionit, ndërgjegjësimin, të të kuptuarit dhe edukimit lidhur me çështje të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ngacmimeve e dhunës seksuale.

Falënderojmë Edlira Ngjeci për ndihmesën, komentet dhe sugjerimet.

Mirënjohje gjithashtu për të gjitha organizatat e grave dhe punonjëseve të tyre, pionere të ofrimit të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale dhe, shpeshherë, forca dhe mbështetja e tyre e vetme.

Vëmendja dhe mbështetja e dedikuar e organizatave dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal, po ashtu organizatave dhe agjencive ndërkombëtare/donatorëve ka bërë të mundur ofrimin e shërbimeve profesionale për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale. U jemi mirënjohëse!

AWEN

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJA DHE KONTEKSTI	10
1.1. OBJEKTIVAT	11
1.2. PYETJET KËRKIMORE	12
2. KUADRI LIGJOR	13
3. KUADRI POLITIK	17
4. KUADRI INSTITUCIONAL	18
4.1. NIVEL QENDROR	18
4.2. NIVEL VENDOR	19
4.3. OFRIMI I SHËRBIMEVE NGA ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE	20
5. METODOLOGJIA	22
5.1. QASJA	22
5.2. INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE DHE KAMPIONI	22
5.3. ANALIZA E TË DHËNAVE	23
5.4. ÇËSHTJET ETIKE DHE KUFIZIMET	23
6. GJETJET	24
6.1. I KUPTUARI I DHUNËS SEKSUALE DHE NGACMIMIT SEKSUAL	24
6.2. FORMAT E DHUNËS SEKSUALE DHE TË NGACMIMIT SEKSUAL	25
6.3. SI PËRJETOHET DHUNA SEKSUALE DHE NGACMIMI SEKSUAL DHE ÇFARË PASOJASH KANË ATO	26
6.4. FAKTORËT E RREZIKUT DHE ATA MBROJTËS	28
6.5. KËRKIMI I NDIHMËS: FAKTORËT PENGUES DHE MUNDËSUES DHE ROLI I AKTORËVE TË NDRYSHËM	33
7. PËRFUNDIME	39
8. REKOMANDIME	41
9. REFERENCAT	44
SHTOJCA - INSTRUMENTET E STUDIMIT	46
INTERVISTA ME TË MBIJETUARA TË DHUNËS SEKSUALE	46
DISKUTIM NË FOKUS GRUP	48
DISKUTIM NË FOKUS GRUP	50

SHKURTIME

AWEN	Albanian Women's Empowerment Network (Rrjeti i Fuqizimit të Grave në Shqipëri)
CEDAW	Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women (Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave)
INSTAT	Instituti i Statistikave
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
OJF	Organizata Jo – Fitimprurëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PMF	Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

FJALORTH I TERMAVE

DHUNË sipas Ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 përkufizohet: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

VIKTIMË sipas të njëjtit ligj cituar më sipër, përkufizohet “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

DHUNË NË FAMILJE “Çdo akt i dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis bashkëshortëve ose partnerëve ose midis ish-bashkëshortëve ose ish-partnerëve, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”. Ligji shqiptar “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” e përkufizon dhunën si “çdo akt dhune i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën” (ndryshuar në vitin 2018). Neni 130/a i Kodit Penal të Shqipërisë e përkufizon dhunën në familje si “rrahja, si edhe çdo vepër tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish - bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij”.

DHUNË FIZIKE përkufizohet “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fytyrë, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytyrjes. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga

ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër”.

DHUNË PSIKOLOGJIKE përfshin “Një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, poshtërojnë, mbajnë nën kontroll, izolojnë, trembin shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetë-vlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkaktuarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike.

DHUNË EKONOMIKE: “Mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimit të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh. mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim, etj.”.

DHUNË SEKSUALE: “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera - për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mos marrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur

personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin - për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin përdhunimin, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim duke përdorur shtrëngimin – edhe nëse në masë të vogël - i vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si tentativë për përdhunim. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si përdhunim në grup. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat sulm seksual, përdhunim, abuzim seksual dhe dhunë seksuale përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë”.

DHUNË NDAJ GRAVE: “Kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të rejat dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jo-partner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjinitale femërore”.

DHUNË ME BAZË GJINORE: “Dhuna që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale”. Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdikriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

NGACMIM SEKSUAL: “përkufizohet si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo-verbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes” Ngacmimi seksual është gjithashtu vepër penale dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH sipas të cilit: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë,

duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

PËRNDJEKJE: si vepër penale, parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

MARRËDHËNIE INTIME: sipas Ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3, përkufizohet si “Marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional”

DHUNË NGA PARTNERI INTIM: “Çdo sjellje në një marrëdhënie intime që shkakton lëndim fizik, psikologjik ose seksual të personave në një marrëdhënie, përfshirë veprime të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjelljes së kontrolluar”.

DHUNË NË LIDHJE DASHURIE: “Modele të sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll tek partneri në lidhjen dashurore”. Në mënyrë të ngjashme, Instituti Europian për Barazinë Gjinore e përkufizon dhunën në lidhjen dashurore si “lloji i dhunës nga ana e partnerit intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë”.

SULM SEKSUAL: “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale

ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t'u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit, ose kërcënimeve. Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit. "Akt seksual me kontakt fizik" përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, preken/kontaktin seksual. "Akt seksual pa kontakt fizik", përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet), ekspozimin apo zbulimin e organeve gjenitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

ABUZIM SEKSUAL I FËMIJËVE: Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtari të ngushtë të familjes (incesti) ose midis një fëmije dhe një të rrituri, apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, jo anëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktimja për shkak të moshës së tij/të saj ose të saj.

SHFRYTËZIM SEKSUAL: Çdo abuzim aktual ose përpjekje për abuzim, për qëllime seksuale, nga një pozicion i pafavorshëm, ndryshimi në pushtet, ose besimi, përfshirë por pa u kufizuar tek përfitimi monetar, në mënyrë shoqërore, ose politike, nga shfrytëzimi seksual i tjetrit.

1. HYRJA DHE KONTEKSTI

Dhuna ndaj vajzave dhe grave është një fenomen shqetësues i kahershëm në kontekstin shqiptar dhe në të gjithë botën. Ajo i referohet dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike (përfshirë frikësimin, vuajtjen, detyrimin, privimin e lirisë brenda familjes ose në komunitetin e gjerë, ngacmimin seksual etj.).¹ Në Shqipëri, Anketa për Dhunën nga Grave dhe Vajzave tregoi 1 në 2 gra, ose 52,9 përqind e përgjigjedhëneve pohuan se kanë përjetuar të paktën një herë dhunë gjatë jetës së tyre, dhe 36,6 përqind prej tyre se aktualisht ishin duke përjetuar dhunë. Format më të shpeshta të dhunës janë përjetuar dhe përjetohen gjatë një lidhjeje dashurie ose në familje dhe ushtrohen nga partneri intim. Forma më e shpeshtë e dhunës në familje nga partneri intim është kontrolli shtrëngues, pasuar nga dhuna psikologjike dhe dhuna fizike dhe/ose ajo seksuale. Dhuna ekonomike e përjetuar në familje nga partneri intim është i vetmi tregues i pandryshueshëm në kohë.²

Në nivel global, një në tre vajza në të gjithë botën janë dhunuar seksualisht nga partnerët ose ish – partnerët e tyre. Të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë pasoja serioze në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, në shëndetin riprodhues dhe seksual, të cilat mund t'i vuajnë për një kohë shumë të gjatë, edhe pasi dhuna apo abuzimi të ketë përfunduar.³

Janë të shumta studimet që tregojnë përhapjen dhe thellësinë e dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave në Shqipëri. Një studim i vitit 2020 nga organizata AWEN ka treguar se pjesa më e madhe e përgjigjedhëne/ësve mendojnë se dhuna seksuale është një fenomen i përhapur në Shqipëri (80 përqind), e ushtruar nga partnerët, persona

të besuar ose të panjohur, edhe pse kishte ende paqartësi në lidhje me përkufizimin e dhunës seksuale. I njëjti studim tregoi se thuajse 1 në 10 vajza/gra përgjigjedhëne janë detyruar që të kryejnë marrëdhënie seksuale për herë të parë. Vajzat kishin 3 herë më shumë mundësi që të kenë frikë të kryejnë marrëdhënie seksuale për shkak të frikës nga partneri/ish – partneri. Të paktën 15 përqind e përgjigjedhëne/ëve thanë se nuk kanë dalë jashtë shtëpisë ose një vendi tjetër vetëm për shkak të frikës, dhe që kishin frikë të qëndronin vetëm me një person tjetër për shkak të pasigurisë dhe frikës së një sulmi seksual⁴. Një studim i mëparshëm i së njëjtës organizatë e mbështet këtë gjetje. Sipas tij, ka një nivel të ulët të ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës seksuale në Shqipëri dhe një frikë të lartë nga paragjykimet dhe nga fajësimi i viktimës (vajzave dhe grave) për atë që ka ndodhur.⁵ Sa i përket adoleshentëve të moshës 16 – 19 vjeç një studim tjetër tregoi se 22 përqind prej tyre kanë patur të paktën një eksperiencë të dhunës në marrëdhëniet intime. Dhuna u raportua më shumë nga vajzat (28 përqind) sesa nga djemtë (20 përqind).⁶

Dy studime të mëparshme të vitit 2019 janë në të njëjtën linjë, duke treguar kështu se fenomeni ka ekzistuar dhe vazhdon të jetë shqetësues. Studimi kombëtar për dhunën kundër vajzave dhe grave ku ishin përfshirë gra të rritura të moshave 18 – 74 vjeç (2019) ka treguar se gjysma e grave të intervistuar kishin përjetuar dhunë në familje. Gjithashtu, ky studim gjeti se gratë që kishin përjetuar abuzim seksual në fëmijëri kishin gjasa një e gjysmë herë më shumë për të përjetuar dhunë me bazë gjinore si të rritura. Rreth 3 përqind e grave raportuan të

1 IDRA dhe UNWOMEN (2018). Sexual harassment and other forms of gender based violence in public spaces in Albania. E marrë nga: <https://www.idracompany.com/en/neës-publications/neës/un-WOMEN2019> e aksesuar në shtator 2022

2 INSTAT (2019). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. INSTAT: Tiranë

3 "Ending violence against WOMEN" (pa datë). UNWOMEN, e marrë nga <https://www.unWOMEN.org/en/what-we-do/ending-violence-against-WOMEN> e aksesuar në shtator 2022

4 Dhëmbo E., Duci V., (2021) Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.

5 IDRA dhe UNWOMEN (2018). Sexual harassment and other forms of gender based violence in public spaces in Albania. Available at: <https://www.idracompany.com/en/neës-publications/neës/un-WOMEN2019> aksesuar në Shkurt 2022

6 Dhëmbo E., Duci V., (2021) Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021. https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2021/07/AWEN-Dhuna-AL-pages-web_compressed.pdf

jenë abuzuar seksualisht si në fëmijëri.⁷ OSBE – ja në vitin 2019 realizoi një studim mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Shqipëri. Aty rezultoi se 53 përqind e grave të ngacmuara seksualisht nuk kishin folur me askënd për përvojën e tyre. Në rastet kur kishin folur për ngacmimet seksuale që kishin përjetuar, ato rëndom kishin zgjedhur miqtë ose anëtarët e familjes⁸. 34 përqind thanë se kishin përjetuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare dhe 17 përqind pohuan se ishin ngacmuar seksualisht në 12 muajt që i paraprinin intervistës. Gratë në punë të paguara kishin më shumë gjasa të pohonin se kanë pasur ngacmime seksuale përgjatë jetës si dhe në 12 muajt përpara intervistës⁹.

Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021 tregoi se ka një rritje të procedimeve penale në shkallë vendi për krime seksuale me 16 përqind, ndërsa procedimet e dërguara në gjykatë janë rritur me 48 përqind. Pjesa dërrmuese e të pandehurve janë burra (97 përqind) kur një përqindje prej 5.7 përqind janë nën moshën 18 vjeç.¹⁰

Disa akte të dhunës seksuale mund të jenë të fshehura ose ambige, çka e bën të vështirë të kuptuarit e saktë nëse kemi të bëjmë ose jo me dhunë seksuale. Përkufizimet e dhunës seksuale ose të sjelljeve shtrënguese mund të variojnë shumë ndërsa studiohet fenomeni. Wilson dhe Miller (2016) arritën në përfundimin se 60 përqind e vajzave të reja që ishin viktime të dhunës seksuale nuk e konsideronin eksperiencën e tyre si përdhunim dhe nuk mendonin se ishin viktime të dhunës seksuale. Ato përdornin termin “seks i keq” ose “keqkuptim/komunikim jo i mirë” për të përshkruar eksperiencat e tyre. Shkalla e përdhunimit të “paidentifikuar” ishte më e lartë mes vajzave të reja.¹¹ Një studim tjetër ka konkluduar se sa më afër të jetë viktime me abuzuesin aq më pak

mundësi ka që të konsiderojë një veprim si dhunë seksuale.¹²

Përgjatë viteve të fundit kuadri politik dhe ligjor për dhunën seksuale kundër vajzave dhe grave është përmirësuar disi. Megjithatë, ka ende fusha ku legjislacioni ka mungesa si për shembull në situata që nuk përfshijnë dhunën në familje, përfshirë forma të dhunës seksuale, dhe nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për rastet e përdhunimit.¹³ Sa i përket ofrimit të shërbimeve në vitin 2018 është hapur qendra Liliu – një qendër për menaxhimin e krizës në rastet e dhunës seksuale që ofron shërbime të ndryshme për viktimat si shërbime shëndetësore, ekzaminim mjekësor, mbledhjen e të dhënave dhe shërbim psikologjik.¹⁴

1.1. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij studimi janë:

- » Të kryejë një analizë të kuadrit ligjor, politik dhe të ofrimit të shërbimeve;
- » Të eksplorojë fenomenin e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual, dhe format e tyre;
- » Të analizojë faktorët që formësojnë modelet e ndryshme të dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual nga perspektiva e të mbijetuarave;
- » Të kuptojë faktorët shtytës dhe pengues për raportimin e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual dhe kërkesën për ndihmë;
- » Të ofrojë rekomandime për të adresuar barrierat në çështjet e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual.

7 INSTAT (2019). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. INSTAT: Tiranë

8 OSCE (2019). Mirëqenia dhe siguria e grave në Shqipëri. OSCE: Tiranë

9 ibid

10 Prokuroria e Përgjithshme (2021). Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021. Prokuroria e Përgjithshme: Tiranë

11 Wilson, L. C., Miller, K. E. (2016). Meta-analysis of the prevalence of unacknowledged rape. *Trauma, Violence, & Abuse*, 17, 149-159.

12 Orchoëski, L. M., Untied, A. S., Gidycz, C. A. (2013). Social reactions to disclosure of sexual victimization and adjustment among survivors of sexual assault. *Journal of Interpersonal Violence*, 28, 2005-2023

13 INSTAT (2019). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. INSTAT: Tiranë.

14 Child Hub, Liliu - Crisis management centre for cases of sexual violence, 2018, E marrë nga : <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/liliu-crisis-management-center-cases-sexual-violence> e aksesuar në Shtator 2022

1.2. PYETJET KËRKIMORE

Pyetjet kërkimore kryesore për këtë studim janë:

- » Si perceptohet, kuptohet dhe përjetohet dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual? Cilat janë keqperceptimet në lidhje me dhunën seksuale, abuzimin dhe ngacmimin seksual?
- » Cilët janë faktorët shtytës dhe pengues për raportimin e dhunës seksuale dhe kërkimin e ndihmës?
- » Si mund të përmirësohet kuadri politik/ligjor dhe ofrimi i shërbimeve për të rritur raportimin dhe kërkimin e ndihmës?

2. KUADRI LIGJOR

Dy dokumentet më të rëndësishme për adresimin e stereotipave, diskriminimit dhe formave të ndryshme të dhunës ndaj grave janë Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women, në vazhdim CEDAW) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur ndryshe si Konventa e Stambollit). Shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollin shtesë të kësaj konvente me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, duke shprehur kështu vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë. Gjithashtu, ka miratuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në datën 1 gusht 2014. Shqipëria bëri nënshkrimin e Konventës më 19 dhjetor 2011 dhe ratifikimin e saj më 4 shkurt 2013. Përsa i përket dhunës seksuale ndaj fëmijëve një hap i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë ratifikimi i Konventës së Lanzarotës me Ligjin Nr. 10071, datë 9.2.2009, proces i cili i mundësoi vendit përafrimin e kuadrit të vet ligjor me parashikimet e konventës. Procesi të tilla, përfshijnë në radhë të parë amendime të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale¹⁵

CEDAW dhe Konventa e Stambollit adresojnë në nivele të ndryshme dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual. CEDAW ka të përfshirë dhunën me bazë gjinore, por pa përkufizime të detajuara të formave të ndryshme të dhunës. I referohet dhunës dhe abuzimit në familje, martesës së detyruar, vdekjeve të prikës, sulmeve me acid, synetisë femërore ose mutilimin e organeve gjenitale femërore, trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, sulmit seksual, incestit, ngacmimi seksual, sterilizimit të

detyruar dhe abortit, rrahjeve dhe shtrëngimit. Në CEDAW dhuna ndaj grave kufizohet në “dhunën në familje” ose në situata ku gratë janë në marrëdhënie të dhunshme. Gjithashtu, jep një përkufizim të “ngacmimit seksual” (paragrafi 18) por duke e lidhur vetëm me mjedisin e punës.

Konventa e Stambollit ka një fokus më të madh në dhunën ndaj grave dhe përfshin të gjitha format e dhunës. Ajo i referohet në mënyrë të qartë formave të ndryshme të dhunës ndaj grave: dhunës psikologjike (neni 33), përndjekjes (neni 34), dhunës fizike (neni 35), dhunës seksuale, duke përfshirë përdhunimin (neni 36), martesës me detyrim (neni 37), mutilimit të organeve gjenitale femërore (neni 38), abortit të detyruar dhe sterilizimit të detyruar (neni 39), ngacmimit seksual (neni 40), dhe ndihmës së ndihmës për të kryer këto akte (neni 41). Edhe pse nuk përkufizon krime të quajtura “krimet e nderit” ato përfshihen në nenin 42. Gjithashtu, Konventa jep një përkufizim më të gjerë të ngacmimit seksual që shkon përtej fushës së punësimit (neni 40) dhe njeht faktin se si fenomen mund të ndodhë dhe në kushte të arsimit formal dhe joformal ose në mjedise argëtimi.¹⁶

Konventa e Këshillit të Evropës. “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual” (e njohur si Konventa e Lanzarotës) është një hap i madh përpara në parandalimin e krimeve seksuale kundër fëmijëve, ndjekjen e kriminelëve dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë. Duke u bazuar në standardet aktuale ndërkombëtare dhe rajonale, Konventa i zgjeron për të mbuluar dhe kriminalizuar të gjitha krimet seksuale kundër fëmijëve, pa dallim a janë për përfitim komercial ose jo. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është në zemrën e kësaj Konvente. Ajo ka fokusin në respektimin e të drejtave të fëmijëve, sigurimi i mirëqenies së tyre, përgjigja ndaj mendimeve të tyre, nevojave dhe shqetësimeve gjatë gjithë

15 Burazeri, G., Qirjako, G., dhe Tahsini, I. (2015). Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri: Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionalistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Terre des Hommes: Tiranë

16 Këshilli i Evropës (pa datë). The Istanbul Convention and the CEDAW framework: working paper. E marrë nga <https://rm.coe.int/168059aa28> e aksesuar në shtator 2022

kohës në interesat e tyre më të mirë¹⁷. Konventa i kërkon shteteve që të krijojnë një kuadër ligjor dhe institucional për parandalimin e fenomenit dhe për marrjen e shërbimeve nga fëmijët, si dhe për ndëshkimin e kriminelëve të përfshirë në krime seksuale kundër fëmijëve.

Së fundmi, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Organizatës Botërore të Punës për “Dhunën dhe Ngacmimin” 2019 (Nr. 190), e cila zbatohet për dhunën dhe ngacmimin në botën e punës që ndodhin gjatë, në lidhje me ose që lindin nga puna dhe është angazhuar në përmirësimin e legjislacionit dhe përafrimin e tij me atë të BE – së, nxitjen e bashkëveprimit mes organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe rritjen e ndërgjegjësimit, formimit profesional dhe mbrojtjes efektive të viktimave të prekura nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës, duke ndikuar në sigurinë, shëndetin dhe efektivitetin në punë.

Legjislacioni shqiptar ka përparuar mjaftueshëm gjatë dekadave të fundit për t’u përafruar me kërkesat e konventave të sipërpërmendura dhe dokumenteve të tjerë ndërkombëtarë. Kështu, çështjet e dhunës dhe abuzimit seksual dhe e ngacmimit/shqetësimit seksual trajtohen në një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, të cilat paraqiten shkurtimisht më poshtë:

» **KODI PENAL.** Dhuna seksuale është e parashikuar si një vepër penale. Në nenin 100 thuhet “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”. Gjithashtu, Kodi Penal ka një sërë parashikimesh të tjera në lidhje me dhunën seksuale. Këto parashtrohen në: neni 101 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”; neni 102 “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”; neni 102/a “Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur”; neni 103 për “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur”; neni 104 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës”; neni Neni 105 “Marrëdhënie

seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”; neni 106 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”; neni 107 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike”. **Ligji nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”,** i ndryshuar, qartësoi konceptet e formave të dhunës duke kriminalizuar çdo formë të saj dhe duke harmonizuar përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet në ligjin për dhunën në familje.

Në nenin 107/a të Kodit Penal theksohet se: “Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet”. Në vazhdim, në nenin 108 flitet për “Veprat e turpshme”, ndërsa në nenin 108/a jepet përkufizimi i ngacmimit seksual si: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.” Neni 121 ka përfshirë përkufizimin dhe dënimin për përndjekjen.

Edhe pse në Kodin Penal ka një sërë parashikimesh për dhunën seksuale ndaj të rriturve dhe fëmijëve, sërish vazhdon të ketë nevojë për përfshirjen e përkufizimeve më të sakta dhe në përputhje me Konventat e sipërpërmendura për të adresuar këtë

17 Këshilli i Evropës (pa datë). Konventa për mbrojtjen e fëmijëve kundër eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual i Këshillit të Evropës (version i shkurtuar). E marrë nga <https://rm.coe.int/prems-102819-alb-2576-protection-children-a5/168098bd14> e aksesuar në shtator 2022

fenomen. Kështu, nenet 100, 101, 103, 105 dhe 106 nuk përkufizojnë termin “marrëdhënie seksuale” duke iu referuar llojit dhe nivelit të penetrimit (vaginal, anal, oral) i cili është një element thelbësor i veprës penale. Gjithashtu, nenet 107/a, 108 (3) dhe 108/a nuk japin asnjë përkufizim të termit ‘veprime me natyrë seksuale’ i cili në të tre rastet është një element thelbësor i veprës penale¹⁸. Çështja e “mungesës së pëlqimit/miratimit” të palëve të përfshira në marrëdhënie seksuale është ende evazive. Në një kohë që konventat ndërkombëtare qartazi sugjerojnë se dhuna seksuale dhe krimet seksuale përfshijnë të gjitha format e marrëdhënieve seksuale ose veprimeve të turpshme pa pëlqimin e personit, Kodi Penal i referohet vetëm rasteve ku përdoret dhuna, përveç rasteve të marrëdhënieve seksuale me të rritura ku përfshihet termi “pa pëlqimin e njërit prej tyre”. Në rastet e adoleshentëve të moshës 14 – 18 vjeç ose të marrëdhënieve homoseksuale nuk është i përfshirë ky term. Neni 107 përfshin kryerjen e veprimeve seksuale në trupin e një personi tjetër me “objekte” por jo me “pjesë të trupit të një personi tjetër”. Së fundmi, nuk përfshihen veprimet ku me përdorimin e forcës ose pa pëlqimin e personit, detyrohet të përfshihet në marrëdhënie seksuale me një/ disa persona të tretë, por vetëm rastet ku krimi kryhet me bashkëpunim.

Abuzimi seksual i fëmijës trajtohet nga Kodi Penal shqiptar, në mënyrë të copëzuar, me anë të një sërë dispozitash. Këto dispozita mbulojnë gati të gjitha elementet e parashikuara në standardin ndërkombëtar me përjashtim të abuzimit seksual nëpërmjet shtrëngimit dhe kërcënimit. Këto parashikime krijojnë konfuzion dhe vështirësi në të kuptuarin dhe zbatimin e legjislacionit për krime seksuale për fëmijët dhe adoleshentët.¹⁹

- » **KODI I PROCEDURËS PENALE (KPP).** Në Kodin e Procedurës Penale ka disa nene që rregullojnë procesin e kallëzimit penal të detyruar dhe të rasteve kur fillimi i procedimit penal nisët kryesisht (ex – officio). Nenet 281, 282 dhe 283 parashikojnë kallëzimin penal të detyruar nga zyrtarët publikë, nga personeli

mjekësor dhe nga qytetarët e vetëdijshëm për një vepër penale. Neni 284 KPP rregullon fillimin e procedimit penal në Shqipëri dhe parashikon se të gjitha krimet seksuale përveç njërit – nisen kryesisht në Shqipëri (ex officio). Vepra penale e përjashtuar është mbi marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari në Nenin 106 të Kodit Penal. Që nga viti 2015 Shqipërisë i është rekomanduar nga Komiteti i Lanzarotës të ndreqë këtë situatë. **Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”** me shtimin e nenit 58/b “Të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore” kërkon që viktimat e abuzuar seksualisht të pyeten pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini; të refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale; dhe të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.” Gjithashtu, ky ligj legjitimon secilën viktimë të veprës penale të ketë të drejtën të nisë një kërkesë padi për dëmshpërblimin e saj nga autori i veprës penale. Këtë padi viktimat mund ta dorëzojnë edhe në prokurori që të dy proceset të zhvillohen si një i vetëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe nga trashëgimtarët e viktimave.

- » **LIGJI NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, I NDRYSHUAR.** Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballeshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji datojnë në vitet 2018 dhe 2020. Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe proceduriale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale

18 Bisha, E., Sulstarova, A., Shapo, Zh. dhe Ymeri, H., (2019) WebFactor: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri, UNICEF Shqipëri/Shapo Consulting, Tiranë 2019.

19 ibid

me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesa. Ndërsa, me ndryshimet e bëra nëpërmjet Ligjit 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcaktohen masat për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesit, krijimi i regjistrit të urdhrave të mbrojtjes, etj.

- » **LIGJI 18/2017 “PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS”**, ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar “masat e mbrojtjes” që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Ligji nuk ka një nen të posaçëm për abuzimin dhe dhunën seksuale të ushtruar ndaj fëmijëve, por e përfshin atë në format e tjera të abuzimit.
- » **LIGJI NR.7961, DATË 12.07.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 136/2015**, ku theksohen ndër të tjera: marrja e masave të nevojshme për të ndaluar ngacmimin moral të kryer prej punëdhënësit / punëdhënëses dhe nga punonjëset/punonjësit e tjerë, si dhe afishimi i dispozitave mbi ngacmimin moral dhe seksual dhe sanksionet përkatëse; ndalimi i punëdhënësit / punëdhënëses të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual për punëmarrëset/punëmarrësit dhe mos lejimi nga ana e punëdhënësit / punëdhënëses kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrëset / punëmarrësit e tjerë. Raport – Progresi i fundit i Shqipërisë për Bashkimin Evropian thekson se në lidhje me fushën e mos – diskriminimit në punë dhe politikë sociale janë bërë amendime ligjore që përkufizojnë qartë ngacmimin seksual dhe nuk ngarkojnë viktimën me barrën e provës.²⁰
- » **LIGJI 37/2017 “KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR”** që garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon

riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon ri-viktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale. Në lidhje me dhunën seksuale ky ligj ka një nen të veçantë (neni 41 “Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale”), i cili rregullon mënyrën e marrjes në pyetje të fëmijëve dhe adoleshentëve dëshmitarë apo viktima të dhunës seksuale. Sipas këtij neni është i detyruar regjistrimi në audio dhe video për fëmijët viktima ose dëshmitarë të dhunës seksuale, i cili mund të përdoret në seancën gjyqësore pa praninë e tyre. Gjithashtu, parashikon se ata nuk duhet të pyeten në praninë e abuzuesit dhe se procesi gjyqësor zhvillohet me dyer të mbyllura.

- » **LIGJI I VITIT 2008 PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI** përfshin dispozita efikase për diskriminimin për shkak të gjinisë dhe për çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, veçanërisht në marrëdhëniet e punës. Gjithashtu, ligji 10 221 datë 04.02.2010 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përfshin dispozita kundër diskriminimit gjinor dhe praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është pasuruar duke dalë në vendime, për shqetësimin seksual si formë diskriminimi në marrëdhëniet e punës.²¹

Krahas këtij kuadri legjislativ ka një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që parashikojnë marrjen e shërbimeve për viktimat e dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale si: ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror, i cili parashikon shërbime të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara; ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti që ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës seksuale; ligji për strehimin social, sipas të cilit gratë e dhunuara janë pjesë e kategorive që përfitojnë banesa sociale; ligji për asistencën sociale përfshin kategorinë e grave të dhunuara për përfitimin e ndihmës ekonomike.

20 Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian. Raporti i progresit të Shqipërisë 2021. E marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en e aksesuar në shtator 2022

21 OSCE (2019). Mirëqenia dhe siguria e grave në Shqipëri. OSCE: Tiranë

3. KUADRI POLITIK

Shteti shqiptar ka miratuar dhe zbatuar deri tani një sërë planesh strategjike për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, si dhe për të drejtat e fëmijëve duke përfshirë këtu mbrojtjen nga format e ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve. Strategjia e fundit për barazinë gjinore (Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030) e miratuar në vitin 2021 paraqet si sfidë trajtimin në mënyrën e duhur, sipas standardeve e me shërbime të dedikuara të rasteve të dhunës seksuale të ndeshur tek të fëmijët apo të rriturat/rriturit, si në marrëdhëniet familjare edhe jashtë tyre, është gjithashtu një tjetër sfidë. Për këtë arsye në këtë strategji është përfshirë një qëllim strategjik (III) që synon zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe parashikon përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, zgjerimin e gamës së shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës, qasje miqësore në sistemin e drejtësisë dhe edukimin për të drejtat seksuale dhe riprodhuese, ndër të tjerash.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026 sjell në vëmendje mungesën e informacionit të mjaftueshëm rreth shkallës ose përhapjes së abuzimit seksual të fëmijëve, punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit të tyre si dhe paraqet mangësitë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për të pasur një përgjigje të integruar, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe dhuna seksuale, duke përfshirë dhe abuzimin e lehtësuar nga teknologjia. Qëllimi i dytë i kësaj Agjende është “Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve” ku shprehimisht prioritetizohet ngritja dhe përmirësimi i mekanizmave dhe shërbimeve të veçanta dhe të integruara për adresimin e formave më të rënda të dhunës përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin online.²²

22 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026.

4. KUADRI INSTITUCIONAL

4.1. NIVEL QENDROR

Konventa e Stambollit në kapitullin e katërt nga neni 18 deri në nenin 28 bën një përshkrim të detajuar të të gjitha shërbimeve që duhet t'u ofrohen të mbijetuarave të dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale për mbështetjen dhe mbrojtjen e tyre. Kuadri gjithëpërfshirës i shërbimeve fillon me legjislacionin e përshtatshëm, informimin për të, shërbime të përgjithshme mbështetëse (konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimit, trajnimit dhe ndihma në gjetjen e një pune), ndihma për ankesa individuale/kolektive, shërbimet mbështetëse të specializuara veçanërisht për të mbijetuarat e dhunës seksuale, strehëzat, linjat telefonike të ndihmës, mbështetja për viktimat e dhunës seksuale me anë të numrit të mjaftueshëm të qendrave referuese (që kanë një tërësi shërbimesh të nevojshme), mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë, raportimi dhe raportimi nga profesionistët.

Në Shqipëri strukturat përgjegjëse për dhunën seksuale në nivel qendror janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Zyra e Koordinatorit kundër dhunës në familje në Ministrinë e Drejtësisë, Zëvendëskryeministri (përgjegjës për barazinë gjinore). **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)**, duke filluar nga shtatori 2017 përveçse për shëndetësinë është përgjegjëse dhe për zhvillimin e politikave për adresimin e dhunës me bazë gjinore, abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike, etj. Këto përgjegjësi përmbushen nëpërmjet Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, brenda Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zyra e Koordinimit kundër Dhunës në Familje e ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë (në 25.11.2017), për bashkërendimin e veprimeve institucionale në nivel qendror e vendor, për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, kryesisht grave dhe vajzave,

si dhe ofrimin e ndihmës në përshkallëzimin e veprimeve institucionale në këtë drejtim. Zyra ka në përbërje përfaqësuese/përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Shërbimi Social Shtetëror) dhe Ministria e Brendshme (Drejtoria për Krimet, pranë Sektorit për Dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e të Miturve).

Po në nivel qendror, **Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore** (me anëtarësi të rinovuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.239, datë 13.12.2017) është organi këshillimor për drejtimin, përcaktimin dhe zhvillimin e politikave shtetërore për barazinë gjinore, si dhe për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit. Këshilli ngrihet me Urdhër të Kryeministrit, rinovohet një herë në katër vjet, drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në përbërje ka nëntë përfaqësuese/përfaqësues të ministrive të linjës në rang zëvendësministreje/zëvendësministri dhe drejtuesesh/drejtuesish të lartë, si dhe tre përfaqësuese/përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat/cilët zgjidhen mbi bazën e një konkurrimi të hapur, duke patur si kriter eksperiencën dhe kontributin për këto çështje.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon dy shërbime mbështetëse të specializuara në nivel kombëtar, të cilat ofrojnë strehim dhe trajtim afatgjatë me fokus riintegrimin, për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore: Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit.

Një hap pozitiv në ofrimin e shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale ishte hapja e qendrës Liliu, në vitin 2018. Në këtë qendër, ofrohet shërbim emergjent, me një ndalesë, 24/7 dhe afatshkurtër (24 - 72 orë), për viktimat/të mbijetuarit/mbijetuarat e dhunës seksuale dhe familjarët e tyre. Në LILIUM ofrohet modeli socio-shëndetësor, me ekip multidisiplinar me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë. Për

trajtimin afatgjatë të rasteve rol të veçantë luan bashkëpunimi me Mekanizmat e Koordinuar të Referimit.

4.2. NIVEL VENDOR

Në nivel vendor, ekziston Drejtoria e Shërbimit Social në nivel Bashkie përmban Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe të Rererimit (NJVNR), sipas ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”. NJVNR – ja si strukturë ka në përbërjen e saj specialistin për dhunën në familje, punonjësin për mbrojtjen e fëmijëve, administratorin shoqëror por mund të shtohen dhe specialistë të tjerë sipas nevojave të Bashkisë.

Struktura e **Koordinatorit Vendor për Dhunën në Familje** është një pozicion i cili në shumicën e rasteve është bashkuar me Nëpunësin për Barazinë Gjinore për të krijuar “Specialistin për dhunën në familje dhe barazinë gjinore”. Gjithashtu, në nivel vendor, bazuar në Ligjin 9669/2016 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar janë ngritur në të gjitha bashkitë **Mekanizmat e Koordinuar të Referimit** të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (MKR), të udhëhequra nga bashkitë (autoritetet përgjegjëse për ngritjen dhe fuqizimin e këtyre mekanizmave) dhe të bazuara në filozofinë e qasjes shumësektoriale të koordinuar. MKR kanë në përbërje të tyre të gjitha institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (bashkia dhe shërbimet sociale të saj, policia, prokuroria, gjykata, mjeku ligjor, përmbarimi, shëndetësia, arsimit, shërbimi social shtetëror, punësimi, shërbimi i provës, prefekti i qarkut, etj.), si dhe organizata të shoqërisë civile të specializuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrjen në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në tërësi të shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime strehimi, këshillimi psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilituese dhe riintegruese, informim, aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, etj.). Funkcionimi i këtyre mekanizmave ka shumë hapësira për përmirësim. Për përmirësimin e

efektivitetit të ndërhyrjes dhe funksionimit në tërësi të MKR-ve, në qershor 2021 u miratua dhe VKM 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës”. Gjithashtu, në vitin 2021 është përgatitur **Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit, në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar**, në vijim të Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), për t’iu ardhur në ndihmë anëtarëve të këtij Mekanizmi (por edhe institucioneve të tjera përgjegjëse), për të standardizuar veprimet e nevojshme për një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.²³ Ky protokoll është miratuar me urdhrin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale drejtuar të gjitha kryetarëve të Bashkive, si drejtues të MKR – ve.

Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë këtu rastet e abuzimit seksual. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (PMF) është pjesë e NJMF – së dhe bashkëpunon me Koordinatorin për Dhunën në Familje në rastet kur janë përfshirë fëmijë.

Krahas institucioneve dhe shërbimeve në nivel vendor, ekzistojnë dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat janë përgjegjëse për vendosjen e të mbijetuarave të dhunës seksuale në qendrat kombëtare të ofrimit të shërbimeve si dhe kanë një përfaqësues në MKR.

Vitet e fundit janë themeluar disa qendra të strehimit emergjent dhe të ofrimit të shërbimeve në raste të tilla, disa prej të cilave menaxhohen nga Bashkitë, disa të tjera nga OJF dhe njëra prej tyre ka një menaxhim të kombinuar. Shërbimet minimale që ofrohen nga strehëzat janë: strehimi

23 MSHMS (2021). Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës Seksuale tek të Rriturat/it në Nivel Vendor Përmes Qasjes Shumësektoriale të Koordinuar. Tiranë

i sigurt, veshja, ushqimi, mbështetje psikosociale dhe referimi. Shërbime që mund të ofrohen sipas nevojës së rastit janë: shërbime psikologjike, ligjore, mjekësore, financiare dhe asistencë edukative/ arsimore. Këto qendra janë:

- » Qendra të menaxhuara nga bashkitë: Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, Urë Vajgurore, Krujë
- » Qendra të menaxhuara nga organizata të shoqërisë civile (OJF): Shkodër, Korçë, Elbasan, Vlorë
- » Qendra të menaxhuara nga bashkia dhe OJF: në Dibër dhe në Durrës. Në të dytin, është "Qendra emergjente për mbështetjen e grave dhe fëmijëve, një bashkëpunim mes Bashkisë Durrës dhe organizatës World Vision, projekt i mbështetur nga Fondi Social.²⁴

4.3. OFRIMI I SHËRBIMEVE NGA ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Shërbimet kryesore ekzistuese të ofruara nga OJF për gratë dhe vajzat/burrat dhe djemtë e mbijetuar/autorë të dhunës seksuale janë:

- » Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza - LKGV 116 117 - shërbim kombëtar si linjë telefonike ndihme, i menaxhuar nga një OJF – Organizatë anëtare e AWEN;
- » Qendra "Vatra" në Vlorë, e cila është qendra e parë që ka ofruar shërbime për të viktimat e trafikimit dhe të mbijetuarat e dhunës seksuale;
- » Linja e Këshillimit të Burrave dhe Djemve në Tiranë dhe në Shkodër, që ofron shërbime këshilluese për burrat dhe djemtë autorë të veprave të dhunës në familje që nga viti 2012;
- » Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara në Tiranë;
- » ALO 116111 – Linja Kombëtare e Këshillimit për

Fëmijë, shërbim i specializuar, pa pagesë 24/7, i një organizate jo-fitimprurëse për fëmijët e dhunuar;

- » Nisma ARSIS, e cila ofron dhe strehimin e emergjencës deri në 7 ditë për kategoritë në nevojë, përfshirë dhe gratë dhe vajzat e dhunuara;
- » Organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", Tiranë
- » Organizata "Tjetër Vizion", Elbasan
- » Qendra jo – publike me karakter fetar që bëjnë të mundur akomodimit e të mbijetuarave të dhunës seksuale, si Shoqata Komuniteti Papa Xhovani XXIII në Shkodër, Shoqata "Gender, Paqe dhe Siguri në Durrës", Qendra "Sot për të ardhmen" në Durrës, etj.

Në një analizë të funksionimit të mekanizmave të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor në Shqipëri të vitit 2019 rezultoi se të gjitha bashkitë raportojnë mungesë të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës seksuale, për gratë me probleme të shëndetit mendor dhe për burrat autorë të formave të ndryshme të dhunës.²⁵ Në raporte të tjera theksohet mungesa e qendrave të krizës për të mbijetuar/a të dhunës seksuale në nivel vendor. Përjasja aktuale për të ndihmuar vajzat/gratë e mbijetuarat të dhunës seksuale janë ad – hoc, shpesh janë nën ombrellën e shërbimeve shëndetësore të përgjithshme, në dhoma të ndara në strehëzat për gra ose në mjedise të tjera, që nuk janë aspak të përgatitura për të përballuar rastet e të dhunës seksuale²⁶.

Në të njëjtën kohë shërbimet për rastet e ngacmimit seksual janë inekzistente. Përveç raportimit dhe ndjekjes së rastit tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe/ose Avokati i Popullit, shërbime të tjera të specializuara për ngacmime seksuale mungojnë tërësisht. Natyrisht, vajzat ose gratë viktimat të ngacmimit seksual në mjedisin e punës mund të marrin shërbimet që u ofrohen në

24 ibid

25 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UNDP (2019). Analiza e Funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri. MSHMS: Tiranë

26 Llubani, M (pa datë). Mapping of policies and legislation on violence against women and the Istanbul Convention in Albania. European WOMEN's Lobby

përgjithësi grave të mbijetuara të dhunës seksuale, por duke qenë se edhe ofrimi i tyre ka mungesa të theksuara, mundësia për ta marrë shërbime të tilla është shumë e ulët. Sipas Konventës së Organizatës Botërore të Punës për "Dhunën dhe Ngacmimin" 2019 (Nr. 190) mbështetja, shërbimet dhe mjetet juridike për viktimat e dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore duhet të përfshijnë masa, si për shembull: (a) mbështetje për të ndihmuar viktimat për të ri-hyrë në tregun e punës; (b) shërbime këshillimi dhe informacioni, në një mënyrë të arritshme, sipas rastit; (c) linja telefonike 24-orëshe; (d) shërbimet e urgjencës; (e) kujdes dhe trajtim mjekësor dhe mbështetje psikologjike; (f) qendrat e krizave, duke përfshirë strehëzat; dhe (g) njësi të specializuara policore ose oficerë të trajnuar posaçërisht për të mbështetur viktimat.

5. METODOLOGJIA

5.1. QASJA

Ky studim mbështetet në metodologjinë cilësore të kërkimit dhe përdor qasjen fenomenologjike deskriptive (përshkruese). Në përgjithësi, ka një dakordësi mes studiuesve se kërkimi cilësor është veçanërisht i dobishëm në hulumtimin e çështjeve për të cilat kërkohet një shkallë ndjeshmërie që kërkimi sasior nuk e mundëson.²⁷ Kërkimi cilësor është veçanërisht i rekomandueshëm në studimin e tematikave që kanë të bëjnë me abuzimin^{28, 29} dhe traumën.^{30, 31}

Qasja fenomenologjike brenda kërkimit cilësor mundëson përshkrimin, kuptueshmërinë dhe interpretimin e kuptimeve që njerëzit u japin eksperiencave të tyre.³² Në kontekstin e këtij studimi, ajo na mundëson arritjen e qëllimit për përshkrimin dhe kuptueshmërinë e perceptimeve dhe përjetimeve të ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale.

5.2. INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE DHE KAMPIONI

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura në këtë studim u mblodhën dhe analizuan të dhëna cilësore parësore. Kjo u mundësua përmes hartimit dhe aplikimit të dy instrumenteve për mbledhjen e të dhënave: a. intervistë e thëlluar individuale; dhe b. diskutimeve në fokusgrupe.

a. Intervistat e thëlluara me të mbijetuara të ngacmimit dhe/ose dhunës seksuale.

Intervista e thëlluar u hartua dhe u përdor me qëllim dokumentimin e eksperiencave të të mbijetuarave të ngacmimit dhe/ose dhunës seksuale. Ajo ishte e ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësonte eksplorimin e variancionit në eksperiencë, përjetime, perceptime dhe kuptueshmëri, ashtu si edhe të strategjive që të mbijetuarat kanë përdorur në përballimin e ngacmimit dhe/ose dhunës seksuale.

Popullata e të mbijetuar/ave nga ngacmimi dhe dhuna seksuale është e pamundur për t'u identifikuar dhe pasur një kuadër kampioni. Gjithashtu, sensitiviteti i çështjes nën studim në përgjithësi ka një efekt dekurajues tek pjesëmarrësit potencialë.³³ Në këto kushte, për identifikimin dhe rekrutimin e rasteve u përdor kampionimi i qëllimshëm si dhe u kërkua mbështetja e organizatave jo-fitimprurëse që operojnë për ofrimin e shërbimeve në këtë fushë në të gjithë vendin. Në total, pas identifikimit, kontaktimit për informim (ballë përballë ose me telefon) dhe inkurajimit për pjesëmarrje në studim (përmes informimit mbi rëndësinë e studimit dhe parimeve etike në realizimin e tij), dhjetë raste (n=10) pranuan dhe u bënë pjesë e studimit.

Të gjithë pjesëmarrëset ishin vajza dhe gra. Moshë mesatare e tyre ishte 26.7 vjeç, me një shtrirje nga 13 deri në 49 vjeç, në kohën e realizimit të

- 27 Silverio, S. A., Sheen, K. S., Bramante, A., Knighting, K., Koops, T. U., Montgomery, E., November, L., Soulsby, L. K., Stevenson, J. H., Watkins, M., Easter, A., & Sandall, J. (2022). Sensitive, Challenging, and Difficult Topics: Experiences and Practical Considerations for Qualitative Researchers. *International Journal of Qualitative Methods*, 21. <https://doi.org/10.1177/16094069221124739>
- 28 Burgess-Proctor A. (2015). Methodological and ethical issues in feminist research with abused WOMEN: Reflections on participants' vulnerability and empowerment. *WOMEN's Studies International Forum*, 48(1-2), 124-134. <https://doi.org/10.1016/j.esisf.2014.10.014>
- 29 Roberts C., Montgomery E., Richens Y., Silverio S.A. (2021). (Re)activation of survival strategies during pregnancy and childbirth following experiences of childhood sexual abuse. *Journal of Reproductive and Infant Psychology*, 1-13. <https://doi.org/10.1080/02646838.2021.1976401>
- 30 Gooberman-Hill R., Fox R., Chesser T. J. S. (2011). What can qualitative approaches bring to trauma outcome research? *Injury*, 42(4), 321-323. <https://doi.org/10.1016/j.injury.2011.01.021>
- 31 Seal D. W., Bloom F. R., Somlai A. M. (2000). Dilemmas in conducting qualitative sex research in applied field settings. *Health Education & Behavior*, 27(1), 10-23. <https://doi.org/10.1177/109019810002700102>
- 32 Bloor, M., & Wood, F. (2006). Phenomenological methods. In *Keywords in qualitative methods* (pp. 129-130). SAGE Publications Ltd, <https://dx.doi.org/10.4135/9781849209403.n40>
- 33 Shiko p.sh. <https://magnoliaconsulting.org/2017/08/sensitivetopicqualitativeresearch/>

intervistës. Shumica e të intervistuarave ishin në moshë madhore në kohën e mbledhjes së të dhënave (n=8) dhe vetëm 2 prej tyre ishin nën 18 vjeç. Pjesëmarrëset në studim vinin nga zona urbane (n=3), zona rurale (n=4) dhe zona periurbane (n=3). Hera e parë e abuzimit kishte qenë në moshë madhore (n=5) dhe në moshë minore (n=5), ku mosha më e hershme e abuzimit ishte 7 vjeç. Rastet e abuzimit varionin nga incesti (n=2), familjarë të tjerë (p.sh. nga krushqia, n=1), partneri/bashkëshorti ose ish-partneri/bashkëshorti (n=3), dhe raste kur abuzuesi është fqinj/banor i fshatit apo zonës përreth (n=3). Në disa raste, abuzuesit ishin të shumëfishtë (n=2) si p.sh. nga disa vëllezër, apo nga ish-bashkëshorti dhe trafikantë.

b. Diskutime në fokus-grupe

Instrumenti i dytë i përdorur për mbledhjen e të dhënave ishin diskutimet në fokusgrupe. Me qëllim mbledhjen e të dhënave mbi kuptueshmërinë, eksperiencat e ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale, si dhe interpretimet që iu bëhen atyre, u realizuan 5 fokusgrupe, me një total prej 42 pjesëmarrësish, me karakteristikat e mëposhtme:

- » Fokusgrup me burra, në zona urbane (Shkodër, n=9)
- » Fokusgrup me gra, nga zona urbane (Elbasan, n=10)
- » Fokusgrup me gra, nga zona urbane dhe rurale (Dibër, n=5)
- » Fokusgrup me gra, nga pakicat kombëtare (Yzberisht, Tiranë, n=11)
- » Fokusgrup me profesionistë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (Tiranë, n=7)

5.3. ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat u regjistruan (ku pati miratim nga pjesëmarrësit) ose u mbajtën shënim dhe më pas u transkriptuan dhe u analizuan tematikisht duke u fokusuar në këto tematika/çështje kryesore:

- » kuptueshmëria e ngacmimit dhe dhunës seksuale;
- » faktorët që formësojnë eksperiencat dhe përjetimet e ngacmimit dhe dhunës;

- » faktorët e riskut dhe resiliencës;
- » strategjitë e përballimit dhe kërkimi i ndihmës;
- » jeta pas ngacmimit/dhunës
- » politikat/shërbimet dhe nevojat për adresim.

Gjetjet e analizës tematike diskutohen në kontekstin ligjor dhe politik në vend për të dalë edhe me rekomandime konkrete për përmirësimin e tyre në kuadër të qasjeve dhe shërbimeve për parandalim, mbështetje dhe riintegrimin të të mbijetuarave të ngacmimit dhe/ose dhunës.

5.4. ÇËSHTJET ETIKE DHE KUFIZIMET

Pjesëmarrja në studim ka ardhur vetëm pas një miratimi të informuar të pjesëmarrësve të identifikuar, dhe në rastet e të miturave edhe me miratimin e informuar të prindit. Të dhënat janë trajtuar dhe do të raportohen në këtë dokument në mënyrë të tillë për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave dhe anonimatit të të intervistuarave.

Kufizimi kryesor i këtij studimi është mungesa e përfaqësimit të rasteve të burrave ose djemve të mbijetuar të ngacmimit dhe/ose dhunës seksuale. Asnjë nga rastet e identifikuar nuk pranoi pjesëmarrjen në studim. Megjithatë, kjo anshmëri në dukje e studimit nuk është veçse një pasqyrim i incidencës së ngacmimit dhe dhunës në shoqëri, ku pjesa dërmuese e viktimave janë vajza dhe gra. Në këtë kontekst, studimi dhe gjetjet e tij mbeten relevante dhe të dobishme për qëllimin fillestar.

6. GJETJET

6.1. I KUPTUARI I DHUNËS SEKSUALE DHE NGACMIMIT SEKSUAL

Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual nuk janë procese të lehta në Shqipëri. Studimet e mëparshme kanë treguar se shpesh njerëzit nuk kanë informacion për dhunën ose ngacmimin seksual, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime.³⁴ Vajzat dhe gratë pjesëmarrëse në këtë studim pohuan se nuk kanë qenë të informuara për dhunën seksuale ose ngacmimit seksual as në shkollë dhe as nga familjet e tyre. Në shumë raste diskutimi për çështje të tilla në familje konsiderohej “turp”, diçka që i linte pjesëmarrëset në errësirë. Në të njëjtën kohë, në shkollë këto çështje nuk diskutoheshin për të njëjtën arsye. Vajzat e reja që morën pjesë në fokus grup konfirmuan se deri para 5-6 vitesh, që ato ishin nxënëse, situata në shkollë ishte e njëjtë: mësueset ndajnë klasën kur kanë për të folur për çështje të seksualitetit dhe përpiqen ta shmangin ose ta kalojnë shpejt si temë.

“Kur ishim në klasë të 8 – të që do na shpjegonte zysha se çfarë ishte dhuna seksuale ose seksi, zysha na ndante. As ne nuk na e shpjegonte se çfarë ishte dhuna seksuale ose seksi ose na bënte një shpjegim fare të vogël... ishte e sikletshme për ato që të na e shpjegonin. Na shpjegonin më shumë për pjesën e konstruktit trupor dhe na jepnin informacione të përgjithshme” (Vajzë, fokusgrup, Elbasan)

Gjatë diskutimeve në fokus grupe u vu re se kishte një konfuzion mes dhunës dhe ngacmimit seksual. Disa pjesëmarrëse pohuan se dhunë seksuale janë “llafet e pista” që mund të thonë djemtë në rrugë. Disa të tjera thanë se dhuna seksuale ndodh vetëm mes partnerëve, ndërsa ngacmimi seksual ndodh në rrugë. Pak pjesëmarrëse kishin një kuptim të saktë për të dyja konceptet dhe për faktin se dhuna seksuale mund të ekzistojë dhe brenda martesës. Nga ana tjetër, kishte pjesëmarrëse që nuk e

kishin dëgjuar asnjëherë si koncept. Përfaqësueset e shoqërisë civile kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me shkallën e madhe të përhapjes së ngacmimit seksual në shkollë dhe në mjedise të tjera dhe shkallën e ulët të informimit për të, ndërgjegjësimit dhe dallimit nga sjellje të tjera. Shpesh OSHC-të gjenden përballë vështirësive nëse duan të diskutojnë për tema si abuzimi seksual në shkollë, ndërkohë që vetë fenomeni është tejet i përhapur.

“Të ndryshojë narrativa publike – duhet t’i themi gjërat me emrin e vërtetë. Brenda institucioneve ka njerëz që e kanë për turp të flasin për këto – ndërkohë që ngacmimi në shkollë, në autobus, në mjedise publike bëjnë kërdrinë. Në Londër pashë në autobus që shkruante “touching inappropriately is equal to harassment – prekja e papërshtatshme është njësoj me ngacmimin.” Çfarë i kushton bashkisë ta vendosi këtë në shkollë. Nuk ka nevojë që t’i lusim ne por e kanë detyrim se ka kuadër ligjor” (Përfaqësuese e shoqërisë civile, Tiranë)

Gjithashtu, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile çështja e ngacmimit seksual është ende evazive në Kodin Penal, pasi akoma nuk janë të përshkruara saktësisht format e ndryshme të ngacmimit seksual, pavarësisht se përkufizimi i tij është aty. Ato treguan raste ku gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë nuk përfytyronin/perceptonin si “ngacmim seksual” komentet ose format e tjera të ngacmimit që nuk përfshinin prekjën.

Përhapja e fenomenit të dhunës seksuale perceptohej si e madhe dhe e shtrirë në të gjithë Shqipërinë, me tendencë drejt përkeqësimit. Pjesëmarrëset në fokus grupe kanë përshkruar raste të ndryshme të abuzimit seksual që janë bërë mediatike, por edhe raste të njohura nga rrethi i tyre shoqëror dhe më gjerë/afër. Kur u pyetën se ku mendojnë se është me i përhapur si fenomen, disa kanë thënë në zona urbane. Gjithashtu,

34 Dhëmbi E., Duci V., Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.

djemtë e lidhnin ngacmimin seksual me përdorimin më të madh të internetit dhe e kanë parë më të pranishëm në zonat urbane.

“Dhuna seksuale është përkeqësuar. Është më e përhapur në zona urbane. Edhe në zona rurale ka por janë më të rralla rastet.” (Vajzë, fokusgrup, Elbasan)

Ngacmimi seksual u raportua gjithashtu si një fenomen i përhapur kryesisht mes grave të divorcuara. Duke qenë se shumë pjesëmarrëse ishin të mbijetuara të dhunës seksuale, ato kishin patur eksperiencat e tyre të kërkimit të një banese me qira ose të një pune. Ato kanë përshkruar shumë raste ku janë ngacmuar seksualisht nga pronari i banesës ose pronari i biznesit.

“Ne që jemi me qira e kemi shumë të vështirë, do shkosh tek pallati dhe do të të privatizojë ai i pari, se e dinë që jemi të divorcuara.” (e mbijetuar e dhunës seksuale brenda familjes, zonë urbane)

“Sa e morën vesh tek puna ime se isha e divorcuar filloi si pronari, si biri i pronarit që të më ngacmojnë...edhe unë ika, nuk i dua as lekët, asgjë...një siklet tjetër e hoqa. Të vete të punoj me stres, pse? Se më ngacmon çuni i pronarit... nesër do krijoj një familje, çfarë do i them atij tjetrit.” (e mbijetuar e dhunës seksuale brenda familjes, zonë urbane)

Në shumicën dërrmuese të rasteve vajzat dhe gratë mendonin se ato ishin më të prekura nga abuzimi, dhuna seksuale dhe më tej ngacmimin seksual krahasuar me djemtë dhe burrat. Vlen për t'u theksuar fakti se në fokus – grupin e djemve u diskutua se djemtë më të vegjël të moshës 6-7 vjeç mund të jenë më të rrezikuar se sa vajzat adoleshente të moshës 13 – 14 vjeç.

6.2. FORMAT E DHUNËS SEKSUALE DHE TË NGACMIMIT SEKSUAL

Format e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual mund të variojnë në varësi të personave të përfshirë dhe të llojit të ngacmimit apo dhunës seksuale. Pjesëmarrëset e studimit përmendën disa raste të dhunës seksuale në formën e saj më të rëndë –

përdhunimit – por edhe raste të dhunës seksuale ndaj fëmijëve me përpjekje për të përfituar veprime seksuale si dhe të ngacmimit seksual në mjedise publike, në shkollë, në polici, në kërkesën për banesë dhe në punë.

Në mjedisin shkollor janë bërë mediatike raste të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, kryesisht vajzave adoleshente. Diçka e tillë u përmend dhe në një nga fokus grupet, ku njëra prej vajzave solli shembullin e një vajze të përdhunuar nga një punonjës ndihmës i shkollës, ndaj të cilit nuk u mor asnjë masë veç largimit nga puna, pasi vajza nuk e denoncoi.

Shumë raste të dhunës seksuale të përmendura kanë qenë brenda mjedisit familjar ose rrethit të besimit, ndaj gruas/partneres ose ndaj fëmijëve. Kështu, janë përmendur raste të abuzimit seksual nga xhaxhai, nga njerku dhe nga gjyshi i bashkëshortit.

“Xhaxhai bënte gjeste me prekje, ka ndodhur diku e 3 herë. Ajo mendoi se ndoshta do të ndryshonte...por i ka treguar një familjar që i kishte parë babait të vajzës, që të mos e çojnë më gocën andej. Kur e ka pyetur babai gocën e ka konfirmuar dhe ka shkuar dhe është zënë me vëllain e vetë” (Vajzë, fokusgrup, Peshkopi)

Format më të shpeshta të ngacmimit seksual të përmendura nga pjesëmarrëset ishin komentet me natyrë seksuale dhe kërkesa për favore seksuale kryesisht në mjedisin e punës. Siç u citua dhe më sipër ato hasnin vështirësi në gjetjen e një banese me qira për shkak të statusit të tyre si të divorcuara, si dhe në gjetjen e një pune pa ngacmime. Është shokues fakti që njëra nga vajzat e mbijetuara të dhunës seksuale që mori pjesë në studim raportoi ngacmim seksual nga polici që shkoi për të denoncuar dhunën.

“Kam qenë dhe në polici, nuk është se ka ndonjë shërbim. Edhe atje kam pasur një ngacmim seksual nga një polic, më thoshte ‘Je shumë e bukur...a je ti këtu në telefon? Je shumë e re’...’Ai nuk ka qenë për ty...’ dhe pastaj erdhi babi im dhe ndaloi.” (e mbijetuar e sulmit seksual, zonë urbane)

6.3. SI PËRJETOHET DHUNA SEKSUALE DHE NGACMIMI SEKSUAL DHE ÇFARË PASOJASH KANË ATO

Pasojat e dhunës dhe abuzimit seksual janë të ndryshme. Ato mund të kategorizohen në këtë studim në pasoja emocionale, ekonomike, arsimore, të punësimit dhe të qëndrimeve për të ardhmen. Pasojat emocionale të dhunës seksuale janë të evidentuara në literaturë. Të mbijetuarat e dhunës seksuale përjetojnë një sërë ndjenjash negative si mërzitja që mund të arrijë deri në depresion, çrregullimi i stresit post – traumatik, mendime vetë – vrasëse, ndjenja de – atashimi, ndjesia e të qenit bosh ose e “pisët”, deluzione etj.³⁵ Gjithashtu, shpesh shfaqin probleme shëndetësore ose psikosomatike. Tek fëmijët dhe adoleshentët pasojat janë edhe më serioze.

Një vajzë në moshë të vogël përshkruan se në kohën që abuzohej seksualisht përjetonte:

“Ndjeja zemërim, doja të ikja, por ai më mbante. Më mbante me zor, nuk më linte të ikja. Por jo shumë fort se kishte hall se e shihte babi. Thoshte se po t’i tregosh njeriu do të të vras, më kërcënonte.” (vajzë e mbijetuar e sulmit seksual në moshën 11 – vjeçare, zonë peri – urbane).

Një vajzë tjetër përshkruan se si kishte humbur besimin tek “privatësia” e mendimeve të saj. Shpesh të mbijetuarat e dhunës seksuale e kanë të vështirë të ndjejnë se kanë kontroll mbi trupin dhe mendjen e tyre, edhe kur abuzimi nuk ndodh më.

“Mua më dukej se po ma lexonin mendjen. Filloja dhe ndjeja turp edhe për gjëra të tjera. Kisha siklet nga mendimet e mia se më dukej se m’i dëgjonin mendimet e mia.” (vajzë, zonë rurale)

Një tjetër grua rrëfen se: “Rrija vetëm duke qarë isha shumë e mërzitur, thoja që të pija diçka dhe të vdes, nuk e desha jetën. Me shëndetin vetëm jam shëndoshur, më doli dhe diabeti”. Gra të tjera treguan se kishin frikë dhe stres të lartë, jo vetëm ato, por edhe fëmijët e tyre. Në të njëjtën kohë

pasojat fizike nga vetë dhuna seksuale janë shumë serioze, siç është shprehur një vajzë e mbijetuar:

“Gjatë aktit nga forca ka pasur hemorragji. Në ato momente ka ardhur mami dhe kjo [një familjare] i tha se është vrarë në beton. Ai [dhunuesi] erdhi dhe më çoi në spital, kur është bërë ekspertiza mjekoligjore dhe është njoftuar policia. Kisha shumë hemorragji, më futën në operacion.” (Vajzë, zonë rurale, e mbijetuar e incestit)

Një grua tjetër e ngacmuar seksualisht tregoi se kishte probleme me dhimbjen e kokës që i vazhdonin deri në momentin e kryerjes së intervistës:

“Kisha dhimbje koke, qaja...në momentin që isha vetëm, vetëm qaja, dhimbja e kokës ka vazhduar, akoma e kam...më ka ngelur... më thonë e ke nga stresi. Se unë jam tip që nuk flas. Vetëm qaja, qaja, kisha ankth ngaqë nuk kisha kujt t’ia them” (Grua, Peshkopi)

Përveç përjetimeve në kohën e abuzimit dhe dhunës seksuale këto vajza dhe gra vazhdojnë të kenë pasoja emocionale pas largimit nga dhunuesi. Të gjitha gratë dhe vajzat pjesëmarrëse nuk jetonin më me abuzuesin e tyre. Disa prej tyre kishin ndjenja çlirimi dhe uljes së ankthit pas denoncimit të autorit, ndërsa disa të tjera vazhdonin të përjetonin ndjesi negative.

Kështu, një grua tha se:

“Jam shumë e qetë me veten time dhe kam dy fëmijët në krahë që janë gjëja më e shtrenjtë me mua. Nuk kam stresin që kam pasur...se kisha stres të dilja në një vend të pija një kafe isha e varur. Jam e qetë e di se ku jam dhe ku nuk jam. Por nuk është se jam kënaqur me jetën time, por të paktën të kem fëmijët mirë. Kur nuk e shijon jetën në rini...tani fëmijët më japin kënaqësi që të shtyhem” (grua, zonë rurale, e mbijetuar e dhunës seksuale brenda martesës)

35 Sigurdardottir S, Halldorsdottir S. Persistent Suffering: The Serious Consequences of Sexual Violence against WOMEN and Girls, Their Search for Inner Healing and the Significance of the #MeToo Movement. Int J Environ Res Public Health. 2021 Feb 14;18(4):1849. doi: 10.3390/ijerph18041849. PMID: 33672865; PMCID: PMC7918207.

Megjithatë, shumica e grave që kishin denoncuar partnerët e tyre u përballën me reagime dhe komente negative nga familja e tyre e origjinës dhe nga komuniteti që kanë përkeqësuar gjendjen e tyre emocionale. Disa prej tyre vazhdojnë të jetojnë me frikë, pasi ish – partnerët e tyre vazhdojnë t'i gjurmojnë, t'i kërcënojnë dhe t'i ofendojnë.

“Frika është shtuar se nuk më lë, jam çliruar nga skllavëria ...por jetoj me frikën se mos shfaqet dhe do më vrasë...frika ime më e madhe është se do më ngelen fëmijët jetimë” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e dhunës seksuale brenda martesës).

Në mjedisin social të të mbijetuarave pasoja më serioze është përjashtimi nga shoqëria/komuniteti ose nga familja dhe/ose diskriminimi në mjedisin e punës. Pjesëmarrëset treguan se në shumë raste familja e tyre nuk i mbështeste në vendimin e tyre për të denoncuar bashkëshortin e tyre dhe për t'u ndarë. Veçanërisht vëllezërit duket se janë më striktë kundër motrave të tyre. Përfaqësueset e shoqërisë civile gjithashtu u shprehën se mbështetja e familjes ka një rol të rëndësishëm në marrjen e vendimit për denoncim dhe akoma më shumë në ri – integrimin në shoqëri të vajzave dhe grave të mbijetuara të dhunës seksuale.

“Në fillim çfarë nuk thoshin, më shumë e kam përjetuar keq nga fjalët. Sot e dinë, e shohin ato se si jam unë. Por atëherë më thoshin fjalë të ulëta, kanë mbështetur ish – burrin. Por pastaj kur e kanë parë më pas se si ishte, e kanë parë si kanë shkuar gjërat dhe kanë ndryshuar” (grua, zonë rurale, e mbijetuar e dhunës seksuale)

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe komuniteti ose shoqëria e gjerë e të mbijetuarave. Ato kanë treguar se anëtarët e komunitetit i kanë diskriminuar duke i kritikuar për vendimin që morën, duke thënë komente negative për to dhe duke mos i mbështetur në vendimin e marrë.

“Gratë flasin njëra me tjetrën, unë dal për të punuar dhe kam 4 fëmijë. Kur dal për të shkuar në punë gratë flasin prapa krahëve të mi.” (Grua, zonë urbane, e mbijetuar e dhunës në familje)

Pasojat e dhunës seksuale shtrihen dhe në fusha të tjera të jetës, si p.sh. në punësim dhe në arsimim. Rasti i një vajze adoleshente të përdhunuar nga stafi mbështetës i shkollës dhe me dëshmitar një mësues është shokues. Vajza braktisi shkollën pas përdhunimit ndërsa i ati vetëm debatoi me punonjësin, por nuk e denoncoi. Një vajzë tjetër, raportoi se ajo nuk ka shokë/qe në shkollë dhe që fëmijët e tjerë e tallin (por jo për çfarë ka ndodhur sepse nuk ishin në dijeni). Përfaqësueset e shoqërisë civile kanë evidentuar rolin e prindërve në mbrojtjen e fëmijëve të tyre dhe në raportimin e mëtejshëm të çështjes. Disa prej tyre pohuan se në shkolla është një fenomen i njohur që të “mbyllet aty për aty çështja”, siç ka ndodhur dhe në rastin e vajzave më sipër.

“Problem është edhe zbrapsja e prindërve. Që ndikon shumë në numrin e ulët të rasteve të raportuara. Në vitet e fundit nuk ka ndonjë rritje të ndjeshme. Rastet e raportuara nga dhuna seksuale nuk kanë rritje.” (Përfaqësuese e shoqërisë civile, Tiranë)

Ngacmimi në mjedisin e punës për shkak të të qenit e divorcuar dhe aq më tepër e dhunuar seksualisht ishte shumë i përhapur. Siç është lartpërmendur, shumica e grave që kërkonin punë hasnin ngacmime të shumta seksuale kryesisht nga pronarët e bizneseve.

“Ka pasur raste që kam lënë dhe punën për shkak të ngacmimeve seksuale, se kur të shohin të pambrojtur si grua e divorcuar...u duket sikur direkt...e kam parë që kanë interesa të tjera dhe e kam lënë punën. Këto raste ndodhin shpesh në Shqipëri. Ka pasur raste që kam punuar në një lokal, nga larg por e kuptoja...kur nuk më pëlqen mua skam sesi të vazhdoj. Ndiheh shumë keq kur je në punë, është gjynah.” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e sulmit seksual)

Në shumë raste gratë e mbijetuara nga dhuna seksuale që denoncojnë ish – bashkëshortët e tyre kanë probleme ekonomike, sepse duhet të paguajnë qira mujore, krahas shpenzimeve të tjera që kanë dhe faktin që janë të detyruara që të largohen nga banesa e tyre, pavarësisht nga parashikimet e ligjit të ndryshuar në 2020 për dhunën në marrëdhëniet familjare.

“Kur e kalova këtë traumën e kisha shumë problem, u bë problem tek policia dhe bashkia dhe shumë herë nuk e kam dashur as veten. Thosha si më ka shkuar jeta mua kështu. Shoqja ime më ka ndihmuar, më ka ndenjur afër. S’kisha as bukë për të ngrënë...atëherë mendova se është dikush që është për mua. Më kanë dhënë një dhomë të vogël, pa asnjë send...s’kisha as lekë për të blerë bukë, veç për të futur kokën. Veç për kushtet që kisha unë mu duk shumë e mirë. Ishte vetëm një dhomë me një krevat.” (grua, e mbijetuar e dhunës seksuale, zonë urbane).

6.4. FAKTORËT E RREZIKUT DHE ATA MBROJTËS

Një sërë faktorësh personalë dhe kontekstualë ndikojnë me intensitete të ndryshme në formësimin e problematikës së ngacmimit dhe dhunës seksuale në përgjithësi, ashtu si edhe rast pas rasti. Në këtë seksion ne sjellim atë çka pjesëmarrësit në studim perceptojnë dhe raportojnë si faktorë të cilët mund të cilësohen si përgjegjës për shkallën e vulnerabilitetit dhe rrezikut, ashtu edhe atë të resiliencës dhe mbrojtjes ndaj ngacmimit dhe dhunës seksuale.

FAKTORË TË NIVELIT PERSONAL

Në planin personal, shumë nga pjesëmarrësit në studim, me eksperiencë të drejtpërdrejta të ngacmimit dhe dhunës ose jo, listojnë faktorë stereotipikë dhe nënkuptojnë dhunuesin – burrë dhe viktimën – grua. Në faktorët individualë për burrat dhunues listohen elementë që shtrihen nga nevojat e paplotësuara për të kryer marrëdhënie seksuale tek përdorimi i alkoolit dhe drogës.

“Ata që kanë pasur femër dhe janë të divorcuar mund të dhunojnë më shumë, i shtyjnë nevoja për seks.” (grua, fokusgrup, Dibër)

“Burrat kanë atë epshin...ata janë ngacmues. Edhe çuna dhe goca të vegjël mund të bien pre.” (grua, fokusgrup, Elbasan)

“Ata që pinë kanë më shumë predispozitë, sillen keq me gruan në shtëpi, sikur janë Zoti!” (grua, fokusgrup, Elbasan)

Në disa prej këtyre faktorëve të mbijetuarat kërkojnë të gjejnë shpjegim edhe për zhgënjimin e madh që iu ka ndodhur në rastin kur dhuna seksuale ka ndodhur nga familjarë me lidhje të afërta gjaku.

“Ai merr alkool dhe drogë...Më përpara nuk kam vënë re gjë. e di që merr drogë e ksi gjërash, ka qenë edhe në burg. E gjeta gjyshen fjetun. Me thirri në dhomë. Mbylli derën, desha me dalë po e mbylli me çelës. Nuk munda me dalë.” (Vajzë, dhunuar 15 vjeç)

Për gratë dhe vajzat mendohet se është natyra e tyre e “butë”, mungesa e informimit dhe varësia ekonomike që i bëjnë më të cenueshme.

“Më të mbrojtura janë ato që kanë një punë, që janë të sigurta, nuk bien pre.” (Grua, fokusgrup, Elbasan)

“Gratë janë më të buta si qenie...pastaj edhe mosinformimi bën të vetën.” (Grua, fokusgrup, Elbasan)

Në planin personal, përfaqësues të shoqërisë civile vërejnë se ka një persistim të mendësisë që kur flitet për karakteristika personale, ato që nënkuptohen janë ato të viktimës dhe vulnerabilitetit të saj sesa të dhunuesit.

FAKTORË SOCIALE DHE KONTEKSTUALE

» Prezenca, kujdesi dhe komunikimi prindëror

Në historitë e vajzave dhe grave të dhunuara seksualisht, edhe në radhët e të afërmeve apo njerëzve të besuar, rezultojnë që prezenca e kujdesit prindëror dhe komunikimi i mirë mes tyre të kenë luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Veçanërisht në zona rurale kur puna në bujqësi dhe blegtori kërkon angazhimin me orare të gjata të të dy prindërve, bën që shpesh fëmijët të mbeten pa kujdes apo nën kujdesin e njëri-tjetrit apo të afërmeve të tyre. Kjo rezultojnë jo vetëm në një përkujdes të cinguar, por ndikon edhe në krijimin e hendeqeve në komunikim midis prindërve dhe fëmijëve.

“Unë kam qenë më e vogla dhe kemi qenë shumë të lidhur me vëllezërit. Kam qenë më e lidhur me vëllain e vogël, kam pasur marrëdhënie shumë të ngushta se kemi pasur vetëm 2 vjet diferencë dhe kemi qenë shumë të lidhur, sikur të ishim në një mendje.

Shkonim bashkë në shkollë, më përcillte, bënim detyrat bashkë... Dy vëllezërit më të mëdhenj nuk është se më kuptonin dhe aq shumë... Mami punonte në tokë bashkë me babin dhe mbeteshim vetëm në fëmijët në shtëpi. Kur vija nga shkolla nuk kishim shumë mundësi, kohë që të komunikonte me mua...Kemi pasur edhe xhaxhain afër, ngjitur me ne. Kanë qenë fëmijët e tyre që kujdeseshin për ne, se ishin më të mëdhenj.” (vajzë, abuzuar që 7 vjeç)

Edhe djemtë e burrat pjesëmarrës në këtë studim e listonin komunikimin e mirë me prindërit si një nga faktorët më të rëndësishëm përkrah rëndësisë që i jepnin prezencës së figurave mashkullore në familje dhe gjendjes së mirë ekonomike.

“Dhunuesit nuk guxojnë aty ku e dinë që do ketë pasoja; aty ku babai është prezent, ku ka 2-3 vëllezër, ku gjendja ekonomike është e mirë dhe e dinë se nuk do e lenë pa e ndjekur çështjen, por edhe aty ku ka komunikim të mirë midis vajzës dhe prindërve. Në ato raste ata e dinë që gjëja nuk do mbetet pa u marrë vesh, që vajza do hapet me prindt dhe ata shohin ven tjetër, ku nuk ka babë a vëllezër, ku vajza nuk ka komunikim me prindërit, apo ka frikë prej tyre.” (djallë, Shkodër)

Mungesa totale e prindërve, apo e njërit prind, cilësohet si një faktor i rëndësishëm risku edhe në historitë e të mbijetuarave. Rasti i mëposhtëm ilustron pikërisht impaktin që ka pasur humbja e babit në jetën e saj, vunerabiliteti që ka sjellë, para se të ndodhte sulmi seksual.

“Jetoja në një fshat të Beratit. Ekonomia nuk ishte shumë e mirë, por ishim mirë, shkonim shumë mirë. Shkoja në shkollë...në shkollë nuk kam kaluar mirë se nuk kisha babin. Më mërzisnin [bullizonin që ishte pa baba] dhe tërhiqesha. Babi ka vdekur kur kam qenë 3 vjeçe. Aty ju dukej sikur isha shumë ndryshe dhe nuk arrija të gjeja ngrohtësi në shoqëri. Kam pasur 2-3 shoqe të ngushta, po edhe ato i kisha më shumë nga lagjja, jo nga shkolla.” (vajzë, abuzuar 14 vjeç)

» Arsimimi dhe informimi

Arsimimi, njohuritë dhe niveli i informimit janë faktorë personalë (siç u evidentua edhe më sipër) edhe kontekstualë përcaktues për ngjarjet e ngacmimit dhe dhunës seksuale. Niveli më i lartë i arsimimit në përgjithësi dhe mirë-informimit për edukatën seksuale mendohen si faktorë mbrojtës dhe parandalues. E kundërta raportohet të jetë shpesh mundësuese për situata të ngacmimit dhe dhunës seksuale. Në veçanti, ekspozimi i parakohshëm dhe/ose me materiale të papërshtatshme seksuale bëhen përgjegjës në disa situata, veçanërisht kur si viktimas ashtu edhe dhunuesit kanë qenë minorene. Në këto raste fëmijët mund të mashtrohen drejt perceptimit të abuzimit si dashuri dhe përkujdesje ndërsa dhunuesit të tentojnë të provojnë gjëra ndaj të cilave ekspozohen në mënyrë të papërshtatshme. Rasti i mëposhtëm e ilustron më së mirë këtë gërshetim.

“Kur kam qenë rreth 7 vjeç, kam pasur marrëdhënie me vëllanë...[hesht disa sekonda]... d.m.th. marrëdhënie seksuale me vëllanë. Kur isha unë e vogël unë nuk kuptoja gjë. Kam qenë vetëm unë vajzë në shtëpi, isha e vogël. Mami nuk ishte në shtëpi dhe as babi nuk ishte në shtëpi.. [kur ndodhte abuzimi]. Kam pasur me të tre vëllezërit... nuk ishin të vetëdijshëm se po bënin këtë gjë me mua. I madhi dhe i vogli e kanë bërë një herë, por nuk e kanë vazhduar më, i mesmi ka vazhduar. Sa herë që isha vetëm e bënte këtë gjë. Kur e bënte këtë gjë më thoshte mos i thuaj njeriu. E bënte në fshehtësi. Më thoshte mos fol në shtëpi... I madhi më thoshte mos trego, pusho mos fol. Po të bej këtë gjë, por po të ble diçka. Më blinte gjëra në dyqanet që kisha afër. Unë mendoja se ai më do, se me ble gjëra, dhe ai me puthte, më qeshte dhe bënte këto gjëra dhe mua më dukej se më donte. Më thoshte do fitoj lekë, do të të ble prapë gjëra, vetëm mos thuaj... Në atë kohë unë nuk kuptoja shumë, por shikoja ndonjë film, ndonjë serial dhe ato nuk kanë qenë shumë për moshën e fëmijëve...kur ishte një burrë dhe një grua, i shikonin ata [vëllezërit] dhe unë, dhe më thoshin ja siç i bëjnë ata, po i bëjmë edhe ne.” (Vajzë, abuzuar që 7 vjeç)

Informimi është shumë i rëndësishëm si për parandalim ashtu edhe për raportim, kërkimin e ndihmës dhe për parandalimin e ri-viktimizimit. Këtu është e rëndësishme të nënvijëzohet karakteri

shumë-planësh i asaj që kuptohet me informim. Disa pjesëmarrës në studim u kujdesën të theksojnë se nuk mjafton vetëm informacion dhe ndërgjegjësim lidhur me atë që është e gabuar dhe që duhet t'i shpëtosh, por edhe si të dalësh prej situatave të ngacmimit dhe dhunës seksuale. Një nga të mbijetuarat e dhunës, me një eksperiencë relativisht të gjatë në një strehëz për gratë e mbijetuara nga dhuna e vuri theksin tek mungesa e informacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve të të mbijetuarave të dhunës për t'ia dalë vetë, gjë që do të parandalonte ri-viktimizimin e tyre.

"Ka pasur vajza që dhunohen dhe kthehen përsëri...është gabim. Duhet të gjeni forcë. Nuk ishte vetëm punë ekonomie, apo mos-informimi se është gjë e keqe, dhe donin të ktheheshin ku ishin. Ishte si më e lehtë dhe e thjeshtë se nuk dinin si të jetonin ndryshe, si t'ia dilnin vetëm."(e mbijetuar e dhunës)

Edhe pse rëndësia e arsimimit dhe informimit pranohet gjerësisht, duket se pak ka ndryshuar ndër vite. Hapësirat në të cilat mund të synohet një edukim dhe informim i gjerë vazhdojnë të mos shfrytëzohen. Edukimi seksual ndonëse pjesë e kurrikulës evitohet ose realizohet i pjesshëm dhe ndarazi për vajzat dhe djemtë. Shërbimi psikosocial gjithashtu raportohet të mos angazhohet në ndonjë mënyrë të qenësishme në këtë drejtim. Për më tepër, vetë stafet e shkollave mund të bëhen pengesë për iniciativa të shoqërisë civile që synojnë ndërgjegjësimin dhe edukimin.

"Shkolla dhe shërbimi psikosocial janë hapësira të mira, po mbeten shumë "të thata". Në zona rurale ende i nxjerrin djemtë jashtë në fizkulturë kur ka tema që lidhen me edukimin seksual. Që kur kemi qenë ne në gjimnaz e deri sodit unë nuk di të kem dëgjuar që t'u jetë folur djemve ndonjëherë në shkollë për edukim seksual. Vetë drejtori i shkollës bëhet pengesë e nuk të lejon më shku me fol për këto tema. Pastaj bashkohet edhe komuniteti, thonë: "Ç'bëni?! Jeni t'u na i nxjerrë vajzat doret". Ndërkohë që i kanë fejuë që 15-16 vjeç treçerekun e tyne. Kur kjo ndodh 10 min. larg Shkodrës, imagjino..." (djale, aktivist, Shkodër)

"Shkollat nuk na pranojnë të flasim për abuzimin seksual – po kur na kanë lejuar jashtë Tirane, kemi vënë re një keqinformim, përmes internetit rasteve etj. dhe mitet mbizotërojnë edhe tek adoleshentët." (përfaqësuese e shoqërisë civile, Tiranë)

» Elemente të tjerë të kontekstit familjar

Përveç prezencës dhe përkujdesit prindëror, një sërë elementesh të tjerë të kontekstit familjar formëson situatat e dhunës, përjetimit të saj, mundësisë për të kërkuar ndihmë dhe fuqizuar, ashtu edhe për t'u rimëkëmbur dhe riintegruar pas saj.

Prezenca e (shtuar) e prindërve mund të ndikojë në përjetimet e fëmijëve të tyre kur dhuna ndodh brenda familjes. Ajo iu jep fëmijëve më shumë siguri dhe krijon predispozita që dhuna të kufizohet, frika të ulët, dhe krijohen mundësi që fëmija i abuzuar të kërkojë ndihmë.

Unë i thosha...se kur ishte mami nuk kisha frikë, kur nuk ishin prindërit ai e bënte më shpesh. Sa futesha brenda unë, ai mbyllte derës. Unë rrija me frikë mos është i fshehur mbrapa derës. Kur ishte mami në shtëpi nuk kisha frikë se do e bënte. (vajzë, abuzuar që 7 vjeç)

Shpesh dhuna seksuale i shtohet një konteksti të dhunshëm në terma më të përgjithshëm. Familjet me një historik konfliktualiteti dhe dhune mund të krijojnë mjedis edhe për dhunën seksuale.

"Babi ndërkohë shkoi në burg sepse rrihte mamin dhe na rrihte dhe neve. E ka bërë për një kohë të gjatë, që kur ka lindur. E ka denoncuar mami babin. Që kur kemi lindur babi na rrihte. P.sh. një herë që mendoi se unë po flisja me dy çuna, më rrahu me kabull." (vajzë, e abuzuar në moshën 11 - vjeçare)

Jo rrallë herë kriminaliteti i anëtarëve të familjes lidhet edhe me raste të dhunës seksuale në familje. Në disa nga rastet e studiuara në kuadër të këtij studimi u evidentua se dhunuesit, autorë të incestit, ishin persona me precedentë penalë, që kishin vuajtur dënime për vepra penale, për të cilat edhe

viktimat e tyre mendonin se mund t'i kishin ndikuar abuzuesit.

Mirëqenia shëndetësore dhe psiko-sociale e anëtarëve të familjes është një tjetër faktor kontekstual që mund të ndikojnë në vulnerabilitetin apo reziliencën e viktimave (potenciale) dhe të mbijetuarave të dhunë në përgjithësi dhe asaj seksuale në veçanti. Në rastin e mëposhtëm, fëmijët janë gjendur në situatë vulnerabiliteti si pasojë e humbjes së babit dhe mënyrës së përjetimit të kësaj humbje nga nëna e tyre.

“Mami nuk ishte mirë... se mami pas vdekjes së babit... mami ikte me muaj. Në [e intervistuar dhe vëllai] mbeteshim vetëm. Ato të lagjes më mbanin afër, shumë ngrohtë. Po më shumë si keqardhje...” (vajzë, zonë rurale)

Konteksti familjar si në familjen e origjinës, ashtu edhe në atë që të mbijetuarat krijojnë kanë një rol thelbësor në përballimin e situatës si dhe në procesin e riintegritimit që pason. Këto kthehen në mbrojtësit më të mirë për të parandalimin e riviktimizimit.

“[bashkëshorti] Ka qenë serioz që në fillim dhe më ka thënë do të të marr në Tiranë, me shtëpi, me punë, që të jemi afër. Kur kam njohur atë kam gjetur vetveten. Kemi 1 vit që jetojmë bashkë. Çdo gjë është ok deri tani, nuk jam zhgënjyer dhe shkojmë shumë. Jetoj dhe me vjehrrën... Ai thjesht e di që kam qenë tek qendra. Dhe ia kam thënë pak a shumë si ka qenë puna dhe atij i bëhet qejfi që unë ia kam dalë vetë dhe ai e vlerëson këtë. Ai e quan këtë kapitull të mbyllur. Nuk më intereson e kaluara vetëm ti më thotë, është shumë pozitiv dhe kemi marrëdhënie shumë të ngrohta.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

» Faktorët kontekstualë socialë: mentaliteti dhe stereotipat gjinorë.

Shpeshherë të mbijetuarat e dhunës vijnë nga kontekste familjare dhe sociale ku mbizotëron një mentalitet patriarkal, ku stereotipat gjinore mbeten të ngurtë dhe fajësimi i viktimës predominon. Në këto qëndrime, diferencat gjinore janë më të ngushta, pasi fajësimin e viktimës e artikulojnë dhe

manifestojnë edhe gratë. Në një nga diskutimet në fokusgrupe një pjesëmarrëse do të shprehej: **“Mund të jetë nismëtari mashkulli, por gjithmonë fajtori është femra.”** Sado kategorike dhe irracionale të tingëllojë kjo, evidenca nga rastet e studiuara konfirmojnë se fajësimi i viktimës vijon të mbetet një problem kritik në çështjet e dhunës dhe ngacmimit seksual, dhe se ai nuk njeh limit as kur viktima është preh e dhunë seksuale dhe kur ajo është një fëmijë që sapo ka filluar klasën e parë.

Në të dy rastet e mëposhtme, për të mbrojtur djemtë abuzues, nënat fajësojnë dhe/ose shtrëngojnë bijat apo mbesat e tyre.

“Me të mesmin [vëllain] kam pasur [marrëdhënie] më gjatë, deri në gjimnaz. Një herë ka qenë edhe mami, po kishte punë jashtë. Ai filloi të abuzonte me mua, unë bëra zhurmë dhe mami erdhi të merrte diçka dhe na gjeti. Ai më thotë: “Mjaft, mjaft se po na dëgjon mami!” Në ato momente erdhi mami dhe na gjeti. Në ato momente kam qenë me fund. Ai doli përjashta. Mami më pau nëse kam gjë poshtë dhe kur e pau që nuk kisha, u mërzi, qau dhe më mori të flas me të. Më tha: “Si e bën ti këtë gjë? A e di që jeni vëlla e motër? Si arritët me e bë këtë gjë, është diçka shumë, shumë e keqe.” Ndërsa ai u vesh dhe doli, nuk foli me njeri.”

“Gjyshja m’u lut ta fal [xhaxhain dhunues]: ta shikoj gjallë e mirë, sa jam dhe unë gjallë. Edhe babi dhe disa xhaxhallarë me kanë thënë ta fal.”

Duke fajësuar viktimën, një pjesë kërkojnë ta gjejnë ‘zgjidhjen’ në masa kufizuese për to dhe jo në përballjen dhe adresimin e dhunuesit. Kjo vjen në formën e kërkesave për të mos folur, për të falur, apo për të kufizuar lirinë e vajzës/gruas.

“Kur ikte mami dhe babi i thosha dua me ardh me ju se kisha frikë. Babi nuk e besonte shumë se ai [vëllai] e bënte këtë gjë. Babi thoshte që janë të turpshme këto gjëra dhe nuk duhet me i tregu.” (zonë rurale)

“Babi më pas ishte i mërzhitur, më fliste ashpër... më thoshte mua që ti e ke fajin, se ti shkove. Mami nuk më thoshte gjë. Më ka thënë që të mos dal shumë, të mos shoqërohem me njerëz.” (vajzë, zonë periurbane, e abuzuar 11 vjeç)

Gratë dhe vajzat fajësohen jo vetëm kur janë ato viktimat, por edhe kur viktimat pritet të jenë nën kujdesin e tyre. Në rastet e incesteve familjarët fajësojnë vajzat, viktimat të dhunës, por edhe nënat e tyre që kishin dështuar të “edukonin siç duhej” dhe/ose “parandalonin” që “gjëja të ndodhte”. Kjo në vetvete gjeneronte më shumë dhunë ndaj vajzave dhe grave në familje, siç ilustron edhe në rastin e mëposhtëm.

“Nga këto gjëra niste dhe grindja në shtëpi me mamin dhe babin; ai nuk ia vinte fajin fëmijëve, po mamin. Babi fliste me fjalë të pista në familje. Çdo inat që ishte i joni i drejtohej mamin me fjalë të pista. Kur më kujtohen, i kam ato në mendje, më vjen shumë siklet, turp në vetvete.” (e mbijetuar, zonë rurale)

Paqja nuk gjendet edhe pasi largimit nga dhuna, pasi opinioni dhe mendësia i përndjek gratë edhe në vendimet që ato marrin dhe mënyrat që zgjedhin për t’i mbijetuar dhunës. Ato ndihen të gjykuara dhe fajësuar në vijimësi,

“Këtu në Shqipëri dhuna vjen nga bashkëshorti, por edhe pasi e ndan dhuna vjen nga të tjerët...se ke opinionin. Kur ti e mban burrin që të dhunon të thonë “Si e mban? Pse s’e lë?”. Kur e lë të thonë “Po si e lë?”...Sado që të jetë fajtor burri, vjehrra thotë nuk thotë bravo që i ke dalë për zot...veçse të të mbështesin që po rrit fëmijën dhe nuk i bie në qafë.” (grua, zonë urbane, e dhunuar në familje)

Mentaliteti bëhet pengesë edhe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezave më të rinj. Siç u përmend edhe më sipër familjet dhe komunitetet behën pengesë për edukimin e fëmijëve të tyre, e sidomos për vajzat duke pretenduar se ky lloj edukimi në fakt është ç’edukim apo arsye për “dalje duarsh” të vajzave të tyre. Ky qëndrim është në kontrast me sjelljet e disa prindërve, veçanërisht në zona rurale, ku vajzat fejohen sapo kanë filluar gjimnazin.

“Thonë mos me i fol vajzave për këto gjëna, ndërkohë që treçereku i tyre janë të fejueme që 15-16 vjeç. Unë vërtet nuk arrij ta kuptoj që e fejon fëmijën, e fut në raporte seksuale dhe nuk do ta edukosh e ta mësosh.” (djalë, aktivist, Shkodër)

Edhe në diskutimet me gra e vajza nga zonat rurale dhe nga pakicat si p.sh. pakicat rome, nënvijëzuan problematikën e martesave të hershme. Kjo mendësi i ekspozon vajzat ndaj ngacmimit dhe dhunës seksuale dhe i vendos në pozita vulnerabiliteti.

“Duhet të ketë më shumë informim dhe ndërgjegjësim për vajzat, por edhe për prindërit. Mos i martojnë të vogla dhe të vendosin vetë... Kunata ime është martuar 16 vjeçe; e kanë martuar kaq të vogël në një familje të madhe. Ka qenë në vit të parë në shkollë të mesme. Në fillim ai i tha do e vazhdosh shkollën, pastaj sa e mori në shtëpi i tha: “Jo, ca shkolle!” Tani më thuaj ti sa mund të ngrejë kokë nëse është e dhunuar një fëmijë që është martuar në një familje të madhe dhe nuk e lënë as të vazhdojë shkollën?!” (vajzë, zonë rurale)

» Faktorë të tjerë kontesktualë: ekspozimi ndaj imazheve dhe/ose sjelljeve me përmbajtje seksuale të papërshtatshme dhe bullizmi

Të jetuarit në zona të thella dhe të izoluar ndikon në nivelin e njohurive dhe informimit që kanë fëmijët dhe të rinjtë ashtu si edhe në nivelin dhe format e socializimit që zhvillojnë. Në komunitete të caktuara mund të ketë pak ose aspak ndjeshmëri për nivelin, format dhe përmbajtjen e informacionit apo veprimeve, që behën përpara fëmijëve.

Shembulli i parë është ilustrues për rastet kur fëmijët janë të vendosur në komunitete që i ekspozojnë ata ndaj informacioneve të papërshtatshme, ndërsa i dyti sjell shembull të konteksteve familjare dhe social-kulturore të kryerjes së veprimeve të papërshtatshme në prezencën e fëmijëve.

“Në lagjen ku rrija, unë isha më e vogla. Isha e vetme, ishte një vend që u mbushte me njerëz dhe, kur i thonë, dëgjoja një fjalë që nuk ishte për t’u dëgjuar.” (vajzë, zonë rurale)

“Po çfarë nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë fëmijët... po të flesh të gjithë në një dhomë, fëmija do i shikojë e do i mësojë të tëra.” (grua, minoritet)

Djemtë dhe burrat në fokusgrupe diskutuan lidhur me ndikimin e madh që ka pornografia dhe ekspozimi i hershëm, pa kriter dhe pa informim me materiale me përmbajtje pornografike. Aksesi i lartë në internet dhe mungesa e informimit se si dhe çfarë burimesh të kërkosh dhe përdorësh për informim çojnë në keqedukim dhe në modelim të sjelljeve që mund të gjenerojnë ngacmim dhe dhunë seksuale.

“Pornografia ka një ndikim shumë të madh. Të rinjtë, po edhe fëmijët e vegjël, kanë akses 100%. Një pjesë e mirë e tynja nuk dinë as se çfarë fjalë kyçe me përdor për të kërku në internet dhe pastaj shohin dhe informohen nga çfarë iu del përpara.” (djalë, zonë urbane)

Bullizmi me bazë raportet seksuale raportohet të jetë një faktor shtytës për ngacmim apo edhe dhunë seksuale. Veçanërisht mes djemve, të cilët modelojnë nga materialet pornografike, ka një nivel të lartë presioni dhe bullizimi për t’u përfshirë sa më herët në marrëdhënie seksuale dhe për ta arritur këtë me çdo kusht për të marrë ‘status’ mes shoqërisë së ‘maçove’.

“Ka një presion të jashtëzakonshëm mes djemve. Ata që nuk kanë të dashur vihen në lojë. E ndjejnë shumë presionin, se shohin ata që pretendojnë se kanë 6-7 të dashura dhe thonë si ka mundësi, ai ka 7 e mua më refuzojnë të gjitha. Kjo lloj vuajtje akumulohet dhe me dëshirën për ta treguar veten se edhe unë mundem, edhe unë jam mashkull, arrijnë edhe tek ngacmimi, edhe tek përdhunimi.” (djalë, zonë urbane)

6.5. KËRKIMI I NDIHMËS: FAKTORËT PENGUES DHE MUNDËSUES DHE ROLI I AKTORËVE TË NDRYSHËM

» Kërkimi i ndihmës

Vajzat dhe gratë e mbijetuara tregojnë se të kërkuarit e ndihmës në një kontekst me mentalitet gjykues dhe fajësues për viktimën kërkon një forcë dhe guxim të jashtëzakonshëm, por edhe mbështetje nga familja dhe komuniteti. Këto të fundit shpesh herë luajnë një rol të kundërt, bëhen penguese dhe dekurajojnë të mbijetuarat.

“Do shumë guxim dhe forcë; Zoti ma dha! Që në atë moment unë isha me mendje të qartë – dua të iki! Ika, kërkova ndihmë dhe nuk kam shkelur më në fshat që pas asaj.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

“Ai ka shkruar një letër që unë e kam bërë me dëshirë [raportin seksual]. Se gjyshja, babi dhe disa nga xhaxhallarët më kanë thënë ta fal. Vetëm një xhaxha që kam në Amerikë më ka thënë mos e fal dhe mami. Mami më ka dhënë shumë mbështetje...nuk di si do kisha bërë pa të.” (e mbijetuar e incestit)

“Nuk është se kemi ndonjë shoqëri shumë dashamirëse. Përveç hallit që kisha në atë periudhë, duhet të ikja me vrap...dhe shoqet e mia të punës më thoshin “pse kalon andej dhe jo këtej?” “pse ke ardhur shpejt dhe jo si gjithmonë?”. Përveç shoqeve të ngushta që ka qenë në dijeni të ngjarjeve, por jo të gjitha formave, të tjerët kanë bërë sehirxhiun, më kanë etiketuar.” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e dhunës në familje)

“Na thonë [në shkolla]: “Kush je ti që ndërhysh? Pse t’ia nxjerrim shkollës këtë nam?” po edhe kur ndodh që marrin iniciativën [të mbijetuarat], janë shumë pak dhe gjurmohen nga komuniteti dhe nuk ndihen të sigurta.” (përfaqësuese shoqërisë civile, Vlorë)

Faktorë si ekzistenca, aksesueshmëria dhe vlefshmëria e shërbimeve, informimi dhe niveli i aksesit në to, mbështetja e familjes, dhe besueshmëria në dhe prej institucioneve janë përcaktuese për të nisur procesin e kërkimit të ndihmës dhe për vijueshmërinë. Këto i diskutojmë më specifiku në seksionet në vijim.

» Policia dhe gjykata

Besimi në institucione është vendimtar për t’iu qasur atyre për ndihmë. Po ashtu edhe mbështetja që gjendet në to përcakton jo vetëm ecurinë e marrjes së ndihmës, por edhe të ardhmen për raportin që do kenë të mbijetuarat e tjera me institucione të tilla si policia, gjykata, por edhe media.

Në disa raste policia raportohet të ketë qenë mosbesuese, jondihmuese, intimiduese, e korruptuar dhe riprodhuese e dhunës. Më poshtë janë dëshmitë e disa prej të mbijetuarave mbi eksperiencat e tyre me policinë.

“Kam qenë në gjumë, mbase ka qenë ora tre ose katër e mëngjesit. Thjesht ka ardhur, ka hyrë në shtëpi, më ka ledhatuar dhe puthur dhe kam ikur, natën... dhe kam ikur natën në polici; kam kërkua ndihmë në polici. Nuk më besonin se isha e vogël dhe vetë shefi më thoshte gënjen. Unë kam shkuar në këmbë, nga fshati aty, në orën shtatë të mëngjesit kam arritur. Më ndihmuan dy gra që i gjeta rrugës; më dhanë buke dhe më çuan në polici. U ndjeva keq që ata nuk më besuan në polici. Unë isha shumë e qartë, se po thosha të vërtetën. Më ndodhi kjo gjë, nga filan person... Mendoj se mund ta njihite [shefi i policisë] atë burrin dhe ndaj më thoshte ti gënjen. Më tha tërhiqe denoncimin ti, se ne do të të ndihmojmë, me gjëra të tjera.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

Të mbijetuarave u ka ndodhur të ngacmohen seksualisht nga ata tek të cilët janë drejtuar të

kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje, si në rastin e kësaj të reje nga Dibra.

“Kam qenë edhe në polici; nuk është se ka ndonjë shërbim. Edhe atje kam pasur një ngacmim seksual nga një polic, më thoshte “Je shumë e bukur...a je ti këtu në telefon? Je shumë e re”... “Ai nuk ka qenë për ty...” dhe pastaj erdhi babi.” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e sulmit seksual)

Presioni i policisë dhe/ose gjykatës kanë qenë vendimtarë për vendosjen e drejtësisë dhe fuqizimin e të mbijetuarave. Si pasojë e mungesës së profesionalizmit, intimidimit dhe ngacmimit që të mbijetuarat mund të kenë përjetuar në polici dhe/ose gjykata ato janë tërhequr nga përpjekjet për të marrë drejtësi dhe për të ndëshkuar dhunuesin.

“Unë e tërhoqa denoncimin se e vogël dhe presioni beri punën e vete. Pastaj detyrohesha mendja: tek mua e gjeti ai! - kam thënë. Po nga presioni nuk e kam menduar pjesën e dënimit. Tek [emri i organizatës] më thanë: “Po pse e ke tërhequr denoncimin?” 15-16 vjeç [1 vit pas sulmit seksual] jam bërë pishman që e kam tërhequr denoncimin. Unë vajta që vajta, po është një forcë shumë e madhe të kërkosh ndihmë pa asnjë lloj njeriu që të ndihmon që ta çoja deri në fund.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

Në raport me gjykatat dhe proceset gjyqësore, gjejmë ende dëshmi të sorollatjeve dhe tejzgjatjeve të proceseve apo të presioneve dhe orientimeve për tërheqje nga procesi.

“E fundit ishte seanca e faljes...se ai kishte shkuar edhe një letër se unë e kisha bërë me dëshirë.” (e mbijetuar e incestit)

“Për t’i shkuar në fund do duhej besimi i policisë, po ishte dhe pjesa e...do vije nëpër gjyqe. Kemi shkuar dy herë në gjyq, kur isha 15 vjeçe. Ne tentuam dhe ata e lanë të lirë. Kemi qenë në gjykatë në shkallë të parë dhe të dytë. U mbyll historia pa u dënuar fare personi. Është pa prova pa gjë thanë dhe nuk e dënuan, ndërkohë që

çfarë interesi do kisha unë të gënjeja. Mori kohë procesi. Nuk kishte as dëshmitarë, asgjë...Po kush do e kishte parë në orën 3-4 të mëngjesit?! [ai] Në Shqipëri ishte dhe nuk është paraqitur fare në gjykatë.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

Kërkimet kanë dokumentuar se mosbesimi dhe mosndëshkueshmëria shkaktojnë dëme shtesë tek viktimat e dhunës seksuale. Duke iu thyer besimi dhe pritshmëritë që kanë në institucione ato humbin besimin dhe riviktimizohen, humbin vetveten dhe akumulojnë efekte në shëndetin dhe gjendjen e tyre psiko-sociale.³⁶ Mosndëshkueshmëria luan një rol të rëndësishëm edhe në raport me përpjekjet për parandalim. Pjesëmarrësit djem në studim diskutuan sesi mosndëshkueshmëria shërben si një faktor që ‘inkurajon’ raste të tjera ngacmimi dhe dhune në të ardhmen.

“Mosndëshkueshmëria është kryesorja. Ata nuk guxojnë aty ku e dinë se do ketë hakmarrje e do ndëshkohen. Kur shohin që raste të tjera ia hedhin paq, thonë hajt se s’po na gjen gjë, ç’e gjeti filanin” (djalë, Shkodër)

» Roli i profesionistëve në shkolla dhe sistemin shëndetësor

Përveç policisë, shkollat dhe institucionet shëndetësore janë ‘dyert’ e para ku të mbijetuarat e ngacmimit dhe dhunës seksuale identifikohen dhe/ose kërkojnë ndihmë. Në disa nga rastet në këtë studim identifikojnë mësuesit me një rol kyç në rrjedhën që ka marrë procesi i kërkimit të ndihmës. Ato kanë qenë mbështetja dhe ura e parë e lidhjes me ofrues të tjerë të shërbimeve në shkolle dhe jashtë saj, duke bërë funksional dhe zinxhirin e referimit.

Një nga vajzat e mbijetuara tregon sesi ka përdorur një ese për të kërkuar ndihmën e mësueses.

“Në orën e gjuhës bëra një ese – shkrujta këtë [që i kishte ndodhur]. I thashë zyshës... i thashë

lexoje. “Sa e vërtetë!” më tha. Çdo gjë që kam jetuar ishte atje. Më thirri tek zyra, më foli, më mbështeti; më tha zysha: “Ça të kesh nevojë ne të mbështesim!” ” (shkollë jopublike, Shkodër)

“Kam kërkuar ndihmë se më vinin mendime të këqija. Kur isha në shkollë u dallosha se isha e ndrojtur. Këtë gjë e shikonin edhe mësueset. Kur kam qenë në shkollë të mesme, vitin e fundit shkoja rregullisht, kuptoja diçka më shumë. Kuptova tamam se nuk ishte gjë e mirë [ajo që i kishte ndodhur] dhe kisha nevojë për ndihmë. Kisha një psikologe që ishte nuse në fshatin tonë. I thashë mësueses kujdestare dhe ajo me lidhi me psikologin se kisha nevojë për të folur. Ajo [mësuesja] ishte pak e madhe në moshë dhe kisha pak turp me mësuesen, dhe ajo më tha që të lë takim me psikologin. I thashë që kam pasur marrëdhënie më vëllaun e dytë, ajo më premtoi që nuk do tregonte. Ajo me drejtoi këtu [në strehëzë], pasi më tha që mendoje një herë mirë. Mund të rrish pa frikë. Erdha tek strehëza. Kam bërë vizita me psikologin. Ajo më tha mund të rrish në strehëzën tonë, për t’u shkëputur qoftë edhe një natë.” (e mbijetuar e incestit)

Mjekët dhe infermierët kanë qenë vendimtarë në situata kur presioni i familjes për të mos denoncuar ka qenë i madh, megjithatë garantimi i një mjedisi mundësues dhe i ruajtjes së interesit më të lartë të të mbijetuarës, edhe kur ato kanë qenë minorene, ka lënë për të dëshiruar.

“Erdhi një police dhe një hetues dhe më thanë infermierja dhe mjekja që trego tamam. Unë i tregova, se mami e mori vesh dhe u çmend krejt. Ai [i afërmi dhunues] ishte jashtë dhe ata e çuan në paraburgim. Më erdhën nga ora 11 e natës mjekët me më pa, të nesërmen më kanë ardh psikologët. 5 ditë ndenja tek strehëza. Deri të nesërmen as baba, as gruaja e tij nuk e kanë dit, kur kemi qenë në rajon të nesërmen u kuptua nga ata të gjithë. Kanë dash me ardh gazetarë, por i kanë ndaluar.” (e mbijetuar e incestit)

36 McQueen, K., Murphy-Oikonen, J., Miller, A. et al. Sexual assault: WOMEN's voices on the health impacts of not being believed by police. BMC WOMEN's Health 21, 217 (2021). <https://doi.org/10.1186/s12905-021-01358-6>

"Ishte e turpshme dhe e sikletshme për mua, kisha dhe emocione. Ishin gra që më kanë pyetur tek prokuroria, dhe më mirë që ishin gra. Shkova dhe tek policia pastaj dhe më kanë pyetur dhe aty për të njëjtën gjë. E sikletshme që duhet t'i thosha prapë nga fillimi. E sikletshme që të them të gjitha detajet, më kanë pyetur më shumë ata. Shkova dhe bëra kontroll në spitalin e Durrësit, isha me një mjek që më bëri kontrollin...kisha frikë dhe turp, dhe ishte i dhimbshëm... As psikolog nuk kishte... Ai ishte arratisur ndërkohë, babi si fillim shkoi në prokurori...pastaj shkoi në polici." (minorene, zonë periurbane Durrës)

"Për vajzën në shkollë ajo ka shkuar në banjo dhe roja e ka ndjekur, dhe aty e ka përdhunuar. E ka parë një mësues. Është përhapur si informacion, ashtu e kemi marrë vesh dhe ne. Nuk e kanë denoncuar, vetëm e kanë pushuar nga puna rojen. Edhe psikologët që kemi te shkolla i kanë thënë gocës që ta denoncojë vetë ndërsa të tjerë kanë thënë se e ka bërë me dëshirën e vetë prandaj nuk e ka denoncuar. Babi i kësaj gocës është grindur me atë...Ajo e ka mamin me kancer dhe e përjeton shumë keq." (Fokusgrup, Dibër)

Nga dëshmitë e mësipërme bëhet e qartë nevoja për përmirësim të shërbimeve si dhe për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve. Përmirësimet e shërbimeve kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe në burime njerëzore. Këto do të ndihmonin në evitimin apo minimizimin e situatave si ato të paraqitura më poshtë, në të cilat nuk garantohej ofrimi i një shërbimi cilësor dhe të sigurt për të mbijetuarat që kërkojnë ndihmë.

"Kur isha në makinë ma bëri me sy [xhaxhai dhunues]. Më çoi aty dhe më tha infermierja sa të vijë doktoresha; i treguam mamin. Më pyeti mjekja që e ke bërë me zor apo me dëshirë. I thashë me zor." (e mbijetuar e incestit)

"Bashkëshorti sa herë që vinte në seancat gjyqësore ishte i alkoolizuar dhe në atë gjendje vinte në çdo seancë, e ishte agresiv. Më thoshte:

"Hajde në shtëpi, s'kam grua për të ndarë". (e mbijetuar e dhunës seksuale në familje)

"Gjyqtarët nuk e konsiderojnë që edhe fëmijët të marrin urdhër mbrojtje. I japin urdhrin e mbrojtjes vetëm nënës me idenë që nuk mund t'ia mohosh babait të drejtën për t'u takuar me fëmijën ndërkohë që ky baba është një baba dhunues, i alkoolizuar, ka dhe probleme me shëndetin mendor, siç kemi patur plot raste. Apo, kur ky baba i gjuan nënën në prani të fëmijës, shan dhe fëmijën, edhe madje e godet. Por në gjykatë thonë: "Hë, se një shpullë i dha babai"-shume sfida për të bindur gjyqtarët që fëmija është palë e dëmtuar....Ka patur edhe raste kur rrëzohet tërësisht kërkesa për urdhër mbrojtje, madje është një gjyqtar prototip që i konsideron si konflikte normale që ndodhin në familje e nuk bëjnë pjesë tek dhuna në familje" (përfaqësuese shoqërisë civile, Elbasan)

"Ne kemi edhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem - dhuna në çiftet e bashkëshortëve është shumë e përhapur dhe del shumë vonë, që kuptojmë se ka pasur dhunë seksuale - kalojnë shumë seanca ... Shpesh herë përfshihen edhe fëmijët si dëshmitarë. Kjo është që nuk shihet asnjëherë edhe nga gjyqtarët." (përfaqësuese e shoqërisë civile, Tiranë)

Këto problematika u theksuan edhe në diskutimet me përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë në këtë sektor. Në perceptimin e tyre, përveç policisë, që deri diku ka kuptuar dhe brendësuar rolin dhe përgjegjësinë që ka, institucionet e tjera mbeten ende shumë larg. Një nga pjesëmarrëset e ilustroi me një shembull nga sistemi shëndetësor.

"Edhe një gjë tjetër problematike, institucionet, përveç policisë, nuk kanë asnjë ide se çfarë përgjegjësi kanë dhe si duhet të veprojnë! Nëna kishte çuar fëmijën 5 vjeç për trajtim [pas abuzimit seksual] ajo [mjekja] nuk pranonte të raportonte, nuk donte prishte marrëdhëniet, dhe qendra shëndetësore thoshte nuk kam çfarë bëj!" (përfaqësuese e shoqërisë civile, Tiranë)

» Roli i organizatave jo-qeveritare dhe institucioneve fetare

Organizatat joqeveritare dhe ndërhyrjet e tyre kanë qenë shpesh vendimtare për ofrimin e ndihmës, mos riviktimizimin e të mbijetuarave dhe riintegrimin e tyre. Shërbimet e tyre janë shumë-planëshe dhe me një reagueshmëri dhe profesionalizëm relativisht të lartë. Megjithatë, shtrirja dhe kapacitetet e shërbimeve që ato mund të ofrojnë është e kufizuar dhe jo detyrimisht e qëndrueshme. Në rastet e mëposhtme evidentohet rëndësia që kanë pasur ndërhyrjet e OJF-ve si dhe (mos) prezenca e shërbimeve publike.

“Falë zotit erdhi qendra [emri i qendrës] me makinë. Shërbime sociale dhe psikologjike nuk kishte, shtëpia e fëmijës nuk më pranon se isha 14 vjeç dhe ishte ditë e diel.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

“Kam vlerësim për ndihmën psikologjike, fola u shpreha... ishte qetësim goxha i madh... kam pasur gjyqe të hapura pa fund. Përveç urdhrave të mbrojtjes... ka qenë dhuna në familje, divorci, e apeloj... çdo vendim që jepte gjykata e apeloj. Test ADN për atësinë e fëmijëve... akoma s'po u vjen fundi. Për 2 vite e gjysmë... vitin e parë u rrënova ekonomikisht, plus gjendja emocionale që ka qenë një tmerr i vërtetë. Në kohën e parë kam marrë ndihmë ekonomike, por shumë pak... vitin e parë nuk e dija [për bonusin e strehimit], vitin e dytë u mor vendimi pas 7 muajsh, dhe vitin e 3të e mora. Jam vetëm me rrogën time, 2 fëmijë dhe unë, dhe për t'u paguar kredia ose qiraja... sepse kontributi i babait është 0. S'ka dashur të vijë ndonjëherë të shohë janë apo s'janë fëmijët” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e dhunës seksuale në familje)

Jo vetëm organizatat e shoqërisë civile, por edhe institucionet fetare dalin në pah me një rol të rëndësishëm në informim dhe ndërgjegjësim, ashtu dhe në ofrimin e shërbimeve imediate si shëndetësore, arsimore, të strehimit etj. Por edhe në rastin e institucioneve fetare njohën kufizimet e tyre në shtrirje dhe objektin/diapazonin e punës së tyre.

“Ka ardh një prift dhe ka fol me mua dhe mamin. Pastaj me ka gjet shkollën prifti, dhe konvikti. Kam ik direkt nga fshati, nuk jam kthyer më.” (e mbijetuar e incestit)

“Vetëm internetin kanë. Ah, ka edhe do qendra me bazë fetare dhe OJF që përpiqen të ofrojnë diçka, por janë shumë pak, dhe efekti është i pakët.” (djalë, Shkodër)

» Nevoja për mbështetje shumë-planëshe dhe mirë-koordinim

Ofrimi i ndihmës në shumë plane, i shtrirë në kohë dhe i qëndrueshëm rezulton të jetë strategjia më e mirë për fuqizimin dhe riintegrimin e të mbijetuarave.

“Vetëm një [herë ka ndodhur], dhe me pas ika dhe qëndrova tek [emri i organizatës] për [koha në vite]. U ndjeva mirë, u ndjeva si në një familje të ngrohtë, që më kishte munguar. Më kanë dhënë ngrohtësi, më kanë mësuar si t'ia dal vetë, si të jem e pavarur, t'ia dal vetë dhe mos varem nga një burrë... të bëj punë shtëpie... tamam si një familje me rregull që më kishte munguar. Që kur vajta tek [emri i qendrës] më ka ndryshuar jeta totalisht. Këshillime, lexime, merreshe me aktivitete, shkolla, puna... dhe vendosa, thashë përpiqu të harrosh, ta hedhesh pas, dhe te ecësh para.” (e mbijetuar e sulmit seksual)

Është pikërisht kjo qasje që të mbijetuarat e kanë gjetur vetëm tek organizatat jo-fitimprurëse në formën e strehëzave që paraqitet si thelbësore për të mirë-koordinuar shërbimet e vlefshme dhe për të ndjekur rrugëtimin e rastit drejt fuqizimit dhe riintegrit. Megjithatë, dëshmitë e tyre tregojnë se ato janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme. Është e domosdoshme të shihet se si mund të zhvillohet dhe garantohet më tej një mbështetje shumë-planëshe, e qëndrueshme dhe e mirë-koordinuar nga sektori publik. Dëshmitë e të mbijetuarave tregojnë se ky i fundit është ende larg ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes në këto standarde dhe mungesa e mbështetjes mund t'i çojë të mbijetuarat drejt situatave të reja të vunerabilitetit.

“Tani jam shkëputur [nga strehëza]. Vetëm 6 muajt e para më jepnin lekë për qiranë dhe për ushqime. ...Punoja, kisha mbledhur lekë. Më kanë ndihmuar edhe vëllai dhe motra e tretë. Më dërgonin lekë ose rroba, mami gjëra fshati. Vinin me takoni sillnin gjëra.” (e mbijetuar e sulmit seksual, zonë rurale)

“Nga shteti nuk është se mora ato që kërkoja... nga bashkia; jam futur në punë tani. Për bonusin e qerasë nuk e mora atëherë, edhe nuk e kisha kontratën e qerasë...pastaj e mora nga [emri i organizatës]. Nuk e dija që ishin me sezone, më thanë që u mbyllën letrat. Ky duhet të jetë një shërbim i vazhdueshëm. Ishte shumë e vështirë se vinte muaji i qerasë duhet ta paguaja edhe dritat e njëjta gjë” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e sulmit seksual)

“Kam 4 muaj që jam lidhur me këtë shoqatën, jam munduar të rregulloj një qira te bashkia, por është vështirë. P.sh. çdo 3 muaj duhet të aplikoj, që ne gratë e divorcuara nuk e marrim asistencën fare. Shumë e vështirë, duhet marrë nga bashkia, nga 6%. Asnjë gjë nuk kam marrë. Vetëm 40,000 lekë të vjetra...por çfarë të hash me ato, janë fëmijët, qiraja... Edhe në punë të paguajnë shumë pak 100 ose 200 mijë lekë [të vjetra]. Jam munduar t'i rregulloj me babin, kemi rregulluar bonusin e qirasë” (grua, zonë urbane, e mbijetuar e dhunës seksuale në familje).

“Dola, se tezja më gjeti një djalë të mirë në Belgjikë. Kur vajta aty, tezja ia tha atij historinë time dhe ai më dërgoi mbrapsht. Tani jam kthyer prapë në qendër. Nuk jam gati për të dalë.” (e mbijetuar e dhunës seksuale, në risk trafikimi, 22)

7. PËRFUNDIME

Kuadri ligjor në lidhje me abuzimin dhe dhunën seksuale është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit në përpjekje për ta harmonizuar me kërkesat e standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, ende mbeten disa problematika në lidhje me përkufizimin e përdhunimit jo vetëm në rastet e detyrimit me detyrimin me dhunë, por “pa pëlqimin e personit”. Gjithashtu, ka paqartësi në përcaktimin dhe detajimin e veprave të turpshme dhe të llojeve të ndryshme të ngacmimit seksual, diçka që do të rriste kuptueshmërinë e veprës nga ana e trupave gjykues dhe si rrjedhojë sanksione të përshtatshme për këto vepra.

Mekanizmat dhe strukturat në nivel vendor për adresimin e çështjeve të dhunës seksuale janë të pamjaftueshëm, me mungesë kualifikimesh në këtë drejtim dhe të ngarkuar me më shumë se një detyrë. Nëpunësja/i për Barazinë Gjinore dhe ajo/ai për Dhunën në Familje shpesh bashkohen për të kryer të dyja detyrat, në një kohë ku vetëm së fundmi të gjitha bashkitë kanë strukturën e ekspertit për dhunën në familje në strukturën e tyre. Në këtë kontekst, çështja e adresimit të ngacmimit seksual mbetet evazive dhe pa një orientim të qartë për procesin e adresimit të tij.

Informimi dhe ndërgjegjësimi për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual ishte i pamjaftueshëm dhe konfuz. Ende në shkollat diskutimi i hapur i çështjeve seksuale konsiderohet “tabu” duke shtuar kështu në ngarkesën e stereotipave që mbart kjo çështje. Kur është fjala për abuzimin e djemve – një fenomen që u evidentua në këtë studim – informimi dhe përpjekja për parandalim është akoma më e pakët. Duke anashkaluar informimin, ndërgjegjësimi – parandalimi - ndërhyrja dhe kërkesa e ndihmës bëhen tejmase të vështira. Kështu, duket se arsimimi dhe mirë-informimi janë thembra e Akilit për parandalimin, kërkimin e ndihmës, rimëkëmbjen dhe mos-riviktimizim.

Format e dhunës ose abuzimit seksual varionin nga prekjet dhe ngacmimet pa prekje deri tek përdhunimi. Shumë raste të tilla vazhdojnë të ndodhin në rrethin e besimit, atje ku si fëmijët ashtu dhe të rriturat vajza ose gra e kanë më të vështirë për të kërkuar ndihmë, veçanërisht nën presionin familjar dhe të komunitetit.

Pasojat e dhunës seksuale padyshim që janë serioze për të mbijetuarat e saj. Ato variojnë nga frika, ankthi, zemërimi deri tek pasojat shëndetësore si dhimbje koke, pasojat shëndetësore nga vetë akti i përdhunimit, dhe sëmundje kronike si diabeti ose migrena. Nga ana tjetër, duhet theksuar se pas largimit nga dhunuesi dhe denoncimit të tij shumica e grave të mbijetuara të dhunës seksuale ndiheshin më mirë emocionalisht, pavarësisht kalvarit të proceseve gjyqësore dhe të përpjekjeve të vazhdueshme për riintegrimin e tyre në shoqëri.

Abuzimi, dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual nuk janë fenomene ishullore, ato ndodhin në një kontekst familjar, komunitar dhe shoqëror. Në këtë analizë të situatës ato ishin prezentë në familje me probleme të tjera sociale, si përdorimi i alkoolit dhe drogave, kriminaliteti, dhuna e formave të tjera në familje.

Roli i familjes mbetet kritik për parandalimin e abuzimit seksual dhe për mbështetjen e të mbijetuarave në momentin që kërkojnë ndihmë. Në këtë studim doli në pah se prezenca e prindërve, përkujdesi prindëror, komunikimi i mirë prind – fëmijë dhe besimi reciprok ishin faktorë thelbësorë së pari për informimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe më pas të rriturve për këtë fenomen, dhe më pas për parandalimin dhe ndihmën gjatë përballjes. Kur abuzimi ose ngacmimi ndodh në rrethin e besimit besimi i prindërve tek fëmijët e tyre/adoleshentët është i një rëndësie jetike.

Mendësia patriarkale është ende shumë prevalente në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në zonat rurale, por jo vetëm. Prezenca e stereotipave gjinore të forta shton sfidat në procesin e raportimit dhe kërkimit të ndihmës. Paragjykimet e tipit “sido që të bjerë monedha ti je fajtores” ishin të pranishme thuajse në të gjitha rastet. Kur vajzat ose gratë i nënshtroheshin dhunës ose abuzimit seksual të tjerët i gjykonin, kur ato vendosnin që të denonconin dhunuesit sërish janë gjykuar. Solidarizimi i komunitetit ishte inekzistent, duke nxjerrë në pah vështirësitë për të kapërcyer mendësinë patriarkale në këto komunitete.

Faktorë si vlefshmëria e shërbimeve, informimi dhe niveli i aksesit në to, mbështetja e familjes, dhe besueshmëria në dhe prej institucioneve janë

përcaktuese për të nisur procesin e kërkimit të ndihmës dhe për vijueshmërinë. Stereotipat dhe paragjykimet gjinore duket se janë të pranishme dhe tek institucione si policia, gjykata dhe në shkolla duke e bërë kështu më të vështirë kërkimin e ndihmës dhe duke riviktimizuar viktimën.

Shtrirja gjeografike dhe kohore e ofrimit të shërbimeve të pakta të sistemit publik për të mbijetuarat e dhunës seksuale në familje ishte e pamjaftueshme. Qendrat e emergjencës ku ishin akomoduar të mbijetuarat ishin jopublike. Shërbimet e ofruara nga pushteti vendor dhe qendror si ndihma ekonomike, bonusi i strehimit etj. nuk mjaftonin për të arritur ri - integrimin e këtyre vajzave dhe grave në shoqëri, pasi procesi për t'i përfituar ishte i zgjatur në kohë, burokratik dhe me kritere thuajse përjashtuese (p.sh. për përfitimin e

bonusit të strehimit aplikimi duhet të bëhet në një periudhë kohore specifike, duhet të sigurohet një kontratë qiraje dhe derisa të miratohet kalon një kohë e gjatë). Në këtë kontekst të problematikave në ofrimin e shërbimeve çështjet e ngacmimit seksual në mjedise të ndryshme mbeten të pambuluara me shërbime. Gjithashtu, shërbimet e specializuara për të mbijetuarat e abuzimit seksual ose dhunës seksuale nuk ekzistojnë në shërbimet publike.

OJF - të dhe institucionet fetare kanë marrë një rol lideri në ofrimin e shërbimeve ndonëse për nga natyra e tyre e kanë të pamundur të kompensojnë mangësitë në sistemin publik. Gjithashtu, qëndrueshmëria e tyre është e diskutueshme për shkak të varësisë nga donacionet.

8. REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e këtij studimi, ne sugjerojmë një sërë rekomandimesh të organizuara sipas tematikave kryesore, si më poshtë:

» Përmirësimi i kuadrit ligjor për t'iu përshtatur kërkesave të dokumenteve ndërkombëtare

Ende mbeten disa hendeqe në kuadrin ligjor për të përmirësuar. Është e nevojshme të harmonizohet përkufizimi i "përdhunimit" me standardet ndërkombëtare duke e lidhur jo vetëm me detyrimin por edhe me mungesën e pëlqimi të personit.

Gjithashtu, duhet të specifikohen format e ndryshme të ngacmimit seksual në Kodin Penal, për të lehtësuar kuptueshmërinë e fenomenit.

Së treti, është e domosdoshme të investohet në ngritjen e kapaciteteve të organeve të drejtësisë, e veçanërisht gjykatësve, në lidhje me fenomenin e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual dhe dhënien e dënimeve respektive.

» Edukim i hershëm dhe gjithëpërfshirës

Pavarësisht përpjekjeve të deritanishme, ka një nevojë të madhe dhe të shtrirë në të gjithë territorin e vendit, në zona urbane apo rurale, për më shumë informim dhe edukim për çështjet e dhunës me bazë gjinore në përgjithësi dhe asaj seksuale në veçanti.

Për sa kohë dhuna seksuale shfaqet që herët edukimi për t'u mbrojtur dhe parandaluar nuk është kurrë shumë i parakohshëm.

Kurrikulat e reja dhe trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve në këtë drejtim duhet të tejkalojnë mbifokusimin e deritanishëm vetëm tek karakteristikat dhe kontekstin e viktimës/ të mbijetuarës, por të trajtojnë me të njëjtin intensitet problematikat dhe faktorët që ndikojnë dhunuesit dhe sjelljet e tyre, ashtu si edhe faktin që viktima të ngacmimit dhe dhunës seksuale janë edhe djemtë dhe kurrikula duhet të trajtojë dhe adresojë në mënyrë eksplicite specifikat që lidhen me ta.

Mos-mbyllja apo heqja nga shkolla, por dërgimi i fëmijëve, e veçanërisht vajzave në shkollë për më gjatë, është i rekomandueshëm nga të gjitha palët.

» Edukimi i prindërve dhe komuniteteve po aq i rëndësishëm sa ai i brezave të rinj

Prindërit duhet të jenë target i nismave për parandalimin e dhunës seksuale po aq sa edhe fëmijët. Edukimi i tyre për rëndësinë e prindërimit dhe komunikimit të mirë me fëmijët përkrah atij të lidhur me dhunën me bazë gjinore janë thelbësorë për të pasur efektivitet në adresimin problemeve të dhunës në përgjithësi dhe asaj seksuale në veçanti.

Qeveria, ministritë e linjës, institucione të pavarura, ofrues shërbimesh, organizatat joqeveritare etj., që punojnë në luftën kundër ngacmimit dhe dhunës seksuale duhet të advokojnë dhe angazhojnë gjerësisht komunitetet. Mendësia e tyre shpesh është një barrierë shumë e madhe për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit dhe dhunës seksuale. Në këto përpjekje këta aktorë mund të angazhojnë politikëbërës, median, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, komisione parlamentare dhe anëtarë të caktuar të kuvendit, persona kyç në komunitet, persona të rëndësishëm (VIP-a), etj., për të përcjellë mesazhet ndërgjegjësuese në mënyrë sa më efektive.

» Mos-trajtimi ndarazi i çështjeve të ngacmimit dhe dhunës seksuale

Si në çështje që lidhen me edukimin dhe ndërgjegjësimin, ashtu edhe në ofrimin e ndihmës dhe adresimit afatgjatë të problemeve të ngacmimit dhe dhunës seksuale është e domosdoshme që të ketë një kuptueshmëri dhe të integrohet një perspektivë që nuk i shikon dhe trajton këto probleme ndarazi nga probleme të tjera ekonomike dhe sociale. Konteksti në të cilën janë vendosur viktimat, dhunuesit, të mbijetuarat, familjet e tyre etj., është i një rëndësie të veçantë për t'u kuptuar dhe marrë në konsideratë në çdo ndërhyrje. Po kështu, evidencat që vijnë prej tij duhet të ushqejnë dhe përforcojnë edhe më shumë domosdoshmërinë për shërbime të integruara në mbështetjen e të mbijetuarave dhe trajtimin e burrave dhe djemve dhunues.

Në këtë linjë, në studim u bë e qartë se në përpjekjet për parandalim, por jo vetëm, ka një domosdoshmëri për mbështetje të dedikuar për familjet me një prind, me prindër të larguar (p.sh. në emigracion etj.), për fëmijë me prindër me probleme të sjelljes dhe nivel të ulët të përkujdesit, etj.

» Informimi i duhur, në kohën e duhur, me shtrirjen e duhur

Në kohën e aksesit të pakufishëm në internet dhe kapaciteteve të ulëta të prindërve dhe/ose mësuesve për të kontrolluar tipologjinë, cilësinë, dhe relevancën e burimeve dhe informacionit që aksesojnë fëmijët, është e domosdoshme që të punohet jo vetëm përmes kanaleve të duhura dhe profesionale të informimit (si shkolla, etj.), por edhe me informimin e prindërve dhe aktorëve të tjerë mbi rëndësinë e kontrollit për të minimizuar ekspozimin e papërshtatshëm të fëmijëve në materiale me përmbajtje seksuale dhe për të ushqyer bullizmin apo sjellje të tjera të dëmshme, përfshi dhunën seksuale.

Nga ana tjetër, fushatat ndërgjegjësuese nuk janë kurrë të mjaftueshme dhe aq më pak të tepërta. Fushatat e ndërgjegjësimit duhet të vijojnë me një shtrirje më të madhe, më intensive, dhe më të orientuar në tematika specifike si dhuna seksuale. Si në punët edukuese dhe ato ndërgjegjësuese duhet t'i mësohet problematikës së fajësimit të viktimave, e cila mbetet ende shumë shqetësuese.

» Kthimi i besimit dhe punës profesionale në institucione

Institucionet e edukimit dhe ato shëndetësore, dhe veçanërisht ato ligjzbatuese si policia dhe gjykata duhet të punojnë për:

KTHIMIN E BESIMIT: denoncimet dhe ndëshkueshmëria e krimit të ngacmimit dhe dhunës seksuale do të rrinten nëse rritet besimi në institucionet që duhet ta garantojnë këtë. Këto institucionet mund ta arrijnë jo vetëm duke punuar në mënyrë profesionale, por edhe duke informuar mbi punën dhe arritjet e tyre në mënyrë periodike, edhe me bashkëpunimin e medias.

Në këtë drejtim duhet të punohet jo vetëm me shpërblimin (për punën e mirë, duke e vënë në pah

atë), por edhe përmes ndëshkimit të mungesës së profesionalizmit dhe shkeljes së parimeve etike të punës me të mbijetuarat të dhunës seksuale. Kjo vlen si për institucionet shtetërore, publike, ashtu edhe për ato jo-publike.

NGRITJA E KAPACITETEVE: profesionistët e vijës së parë, ata me detyra dhe përgjegjësi specifike për parandalim, trajtim dhe riintegrim duhet të mos ndalojnë aksionet për ndërtimin dhe përditësimin e kapaciteteve njerëzore, që nga njohuritë dhe aftësitë më bazë, tek ngritja e kapaciteteve për shërbime të specializuara të këshillimit dhe trajtimit të të mbijetuarave të rritura dhe fëmijë, si p.sh. terapia me fokus traumën, etj., të cilat deri më tani rezultojnë të realizohen kryesisht përmes qasjes autodidakte.

PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS: shërbimet cilësore dhe efektive kërkojnë infrastrukturë të përshtatshme. Në një pjesë të mirë të institucioneve mungojnë stafet e kualifikuara po aq sa edhe mjediset e përshtatshme dhe mundësues për të folur, ekzaminuar, etj.

» Mobilizimi i të gjitha burimeve dhe shërbimeve dhe mirëkoordinimi i tyre

Në përpjekjet për parandalim, trajtim dhe integrim, shoqëria jonë nuk e ka luksin për të humbur apo mos shfrytëzuar maksimalisht çdo burim dhe shërbim ekzistues. Strukturat përgjegjëse në bashkëpunim me partnerët e tyre do duhet të hartëzojnë dhe mirëkoordinojnë në vazhdimësi.

Sistemi publik duhet të përforcojë mekanizmat mbështetës, t'i bëjë ato të aksesueshëm dhe të qenësishëm për mbështetjen e të mbijetuarave. Ndërkaq, organizatat e shoqërisë civile të kufizuara në burime dhe shtrirje të aktivitetit dhe shërbimit të tyre, do duhet të jenë më proaktive në ndarjen dhe replikimin e përvojave të mira.

Mirëkoordinim dhe shfrytëzim më i mirë i burime nuk duhet të kufizohet vetëm në sektorin publik dhe atë jo-qeveritar, por do duhet të mendohet si të ftohet dhe të nxitet të mbështesë edhe sektori privat.

» **Garantimi i shërbimeve të specializuara, të shtrira në kohë dhe në hapësirë gjeografike**

Është e padiskutueshme që për adresimin e problematikave dhe nevojave që lidhen me parandalimin, trajtimin dhe (ri)integrimin e të mbijetuarave të ngacmimit dhe dhunës seksuale të ketë shërbime të specializuara, të shtrira dhe të aksesueshme si në kohë dhe në hapësirë. Shërbimet e emergjencës, të përqendruara vetëm në një zonë (qoftë kjo edhe kryeqendra e vendit) janë totalisht pamjaftueshme si për mbështetjen e vazhdueshme që kërkon adresimi rast pas rasti, ashtu edhe për mbulimin me shërbime në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Fragmentarizimi në kohë dhe hapësirë i shërbimeve mund të tejkalohet vetëm me një planifikim, kostim

dhe buxhetim eksplisit të këtyre shërbimeve si në nivel vendor (nga pushteti vendor), ashtu edhe në atë qendror.

» **Monitorim dhe raportim i vazhdueshëm**

Elemente të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale duhet të jenë pjesë e mekanizmave dhe mjeteve të përhershme të monitorimit dhe raportimit, për të gjithë aktorët relevantë.

Paralelisht shoqëria civile dhe akademja duhet të vijojnë të kryejnë hulumtime operacionale dhe analiza situacionale të vazhdueshme me synim krijimin e evidencave për të vlerësuar dhe informuar politikëbërjen dhe vendimmarrjen në këtë sektor.

9. REFERENCAT

- "Ending violence against WOMEN" (pa datë). UNWOMEN, e marrë nga <https://www.unWOMEN.org/en/ëhat-ëe-do/ending-violence-against-WOMEN> e aksesuar në shtator 2022
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026
- Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian. Raporti i progresit të Shqipërisë 2021. E marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en e aksesuar në shtator 2022
- Bisha, E., Sulstarova, A., Shapo, Zh. dhe Ymeri, H., WebFactor: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri, UNICEF Shqipëri/Shapo Consulting, Tiranë 2019.
- Bloor, M., & Wood, F. (2006). Phenomenological methods. In *Keywords in qualitative methods* (pp. 129-130). SAGE Publications Ltd, <https://dx.doi.org/10.4135/9781849209403.n40>
- Burazeri, G., Qirjako, G., dhe Tahsini, I. (2015). Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri: Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. *Terre des Hommes: Tiranë*
- Burgess-Proctor A. (2015). Methodological and ethical issues in feminist research with abused WOMEN: Reflections on participants' vulnerability and empowerment. *WOMEN's Studies International Forum*, 48(1–2), 124–134. <https://doi.org/10.1016/j.ësif.2014.10.014>
- Child Hub, Liliun - Crisis management centre for cases of sexual violence, 2018, E marrë nga : <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/lilium-crisis-management-center-cases-sexual-violence> e aksesuar në Shtator 2022
- Dhëmbo E., Duci V., (2021) Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.
- Goberman-Hill R., Fox R., Chesser T. J. S. (2011). What can qualitative approaches bring to trauma outcome research? *Injury*, 42(4), 321–323. <https://doi.org/10.1016/j.injury.2011.01.021>
- IDRA and UNWOMEN (2018). *Sexual harassment and other forms of gender based violence in public spaces in Albania*. E marrë nga: <https://www.idracompany.com/en/neës-publications/news/un-WOMEN2019> e aksesuar në shtator 2022
- INSTAT (2019). *Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018*. INSTAT: Tiranë
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
- Konventa e Organizatës Botërore të Punës për "Dhunën dhe Ngacmimin" 2019 (Nr. 190),
- Konventa e Këshillit të Europës. "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual"
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
- Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri. MSHMS: Tiranë
- Këshilli i Evropës (pa datë). Konventa për mbrojtjen e fëmijëve kundër eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual i Këshillit të Evropës (version i shkurtuar). E marrë nga <https://rm.coe.int/prems-102819-alb-2576-protection-children-a5/168098bd14> e aksesuar në shtator 2022
- Këshilli i Evropës (pa datë). *The Istanbul Convention and the CEDAW framework: working paper*. E marrë nga <https://rm.coe.int/168059aa28> e aksesuar në shtator 2022
- Ligji 10221/2010 për "Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- Ligji 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
- Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- Ligji 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale"

- Ligji 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"
- Ligji 7895/1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"
- Ligji 7905/1995 "Kodi i Procedurës Penale"
- Ligji 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar
- Ligji 9970/2008 për "Barazinë Gjinore në Shoqëri"
- Ligji nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë",
- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015
- Llubani, M (pa datë). Mapping of policies and legislation on violence against women and the Istanbul convention in Albania. *European Women's Lobby*
- McQueen, K., Murphy-Oikonen, J., Miller, A. et al. (2021) Sexual assault: women's voices on the health impacts of not being believed by police. *BMC Women's Health* 21, 217 (2021). <https://doi.org/10.1186/s12905-021-01358-6>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UNDP (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2025.
- MSHMS (2021). Protokoll i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës Seksuale tek të Rriturat/it në Nivel Vendor Përmes Qasjes Shumësektoriale të Koordinuar. Tiranë
- Orchowski, L. M., Untied, A. S., Gidycz, C. A. (2013). Social reactions to disclosure of sexual victimization and adjustment among survivors of sexual assault. *Journal of Interpersonal Violence*, 28, 2005-2023
- OSCE (2019). Mirëqenia dhe siguria e grave në Shqipëri. OSCE: Tiranë
- Prokuroria e Përgjithshme (2021). Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021. Prokuroria e Përgjithshme: Tiranë
- Roberts C., Montgomery E., Richens Y., Silverio S.A. (2021). (Re)activation of survival strategies during pregnancy and childbirth following experiences of childhood sexual abuse. *Journal of Reproductive and Infant Psychology*, 1–13. <https://doi.org/10.1080/02646838.2021.1976401>
- Seal D. Ë., Bloom F. R., Somlai A. M. (2000). Dilemmas in conducting qualitative sex research in applied field settings. *Health Education & Behavior*, 27(1), 10–23. <https://doi.org/10.1177/109019810002700102>
- Sigurdardottir S, Halldorsdottir S. (2021) Persistent Suffering: The Serious Consequences of Sexual Violence against WOMEN and Girls, Their Search for Inner Healing and the Significance of the #MeToo Movement. *Int J Environ Res Public Health*. 2021 Feb 14;18(4):1849. doi: 10.3390/ijerph18041849. PMID: 33672865; PMCID: PMC7918207.
- Silverio, S. A., Sheen, K. S., Bramante, A., Knighting, K., Koops, T. U., Montgomery, E., November, L., Soulsby, L. K., Stevenson, J. H., Watkins, M., Easter, A., & Sandall, J. (2022). Sensitive, Challenging, and Difficult Topics: Experiences and Practical Considerations for Qualitative Researchers. *International Journal of Qualitative Methods*, 21. <https://doi.org/10.1177/16094069221124739>
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030
- VKM 327, datë 02.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës".
- Wilson, L. C., Miller, K. E. (2016). Meta-analysis of the prevalence of unacknowledged rape. *Trauma, Violence, & Abuse*, 17, 149-159.

SHTOJCA - INSTRUMENTET E STUDIMIT

INTERVISTA ME TË MBIJETUARA TË DHUNËS SEKSUALE

Letër Informuese

Kjo intervistë po realizohet në kuadrin e një studimi për "Analizën e situatës mbi dhunën seksuale në Shqipëri", që po realizohet nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), i cili realizon vazhdimisht studime mbi tema të ndryshme, që lidhen me gratë dhe çështjet e barazisë gjinore. Studimi është bërë në kuadrin e programit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SIDA. Do t'ju ishim mirënjohës/e nëse do të pranoni të bëheshit pjesë e këtij studimi dhe t'i përgjigjeshit pyetjeve tona duke ndarë mendimet dhe përvojat tuaja lidhur me dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual, procesin e përbaljes, atë të të kërkuarit ndihmë dhe fuqizimit dhe riintegritetit pasi i ke mbijetuar dhunës.

Dëshirojmë t'ju sigurojmë se i gjithë informacioni që ne mbledhim do të ruhet me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Asnjë individ apo adresë e veçantë nuk do të mund të identifikohet në asnjë prej fazave të kërkimit/studimit. Pjesëmarrja juaj në studim është krejtësisht vullnetare dhe në çdo çast mund të ndiheni të lira/ë të mos t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara apo të tërhiqeni nga pjesëmarrja në studim.

Informacione të përgjithshme

Mosha _____

Gjinia _____

Niveli i arsimit _____

Punësimi aktual _____

Gjendja civile _____

Zona _____(Urbane ose rurale)

Mosha kur ka ndodhur abuzimi _____

Seksioni 1. Jeta para abuzimit seksual

- » Si ka qenë jeta juaj para se të ndodhte abuzimi?
- » Si do i përshkruanit marrëdhëniet tuaja me familjen, rrethin shoqëror, partnerin/en, me shkollën ose punën? Pse?
- » Si do ta përshkruanit fëmijërinë tuaj? Adoloshencën? Vitet e rinisë?
- » Si do e përshkruanit veten tuaj? Personalitetin tuaj? Çfarë ju karakterizonte?
- » A keni pasur probleme me shëndetin tuaj fizik? Po mendor?
- » Çfarë do të veçonit si ngjarje më të rëndësishme të jetës suaj gjatë viteve përpara se të ndodhte abuzimi?
- » Çfarë konsideroni si më të rëndësishme në jetë? Pse?
- » Çfarë ju jepte kënaqësi dhe çfarë ju shqetësonte?
- » Çfarë mendoni se bënit/kishit bërë mirë deri në atë moment? Çfarë jo?
- » A keni qenë më përpara i/e abuzuar fizikisht? Emocionalisht? Seksualisht? Nëse po, nga kush? E kishit diskutuar me dikë? Pse po/jo?

Seksioni 2. Periudha e abuzimit seksual – jo vetëm një çast në kohë

- » Çfarë do donit që të ndanit me mua për përvojën tuaj të abuzimit seksual? Nga do të donit që ta nisnim?
- » A ka qenë abuzuesi i njohur për ju përpara se të ndodhte? Nëse po, cila ka qenë marrëdhënia juaj?
- » A ka qenë një moment i vetëm apo ishte abuzim i përsëritur? Cili ka qenë reagimi juaj pas abuzimit të parë?
- » A keni pasur momente që humbët besimin/ shpresat se situata do të ndryshojë? (Në veçanti mund të pyesim për: sistemin

mbështetës të familjes/rrethit shoqëror, besimin tek abuzuesi, fajësimin i vetes, kërcënimet ose manipulimin nga abuzuesi, mungesën e informacionit, mungesën e besimit tek institucionet etj.)

- » Çfarë përjetoni fizikisht, emocionalisht ose mendërisht? Po pas ngjarjes/eve?
- » A kërkuat ndihmë? Çfarë shtyhu / pengoi për të kërkuar ndihmë?

(nëse po)

- » Kur ishte momenti që vendosët të kërkonit ndihmë? Çfarë ndikoi për ta bërë këtë?
- » Kujt i jeni drejtuar për ndihmë? Pse pikërisht aty?
- » Cili ishte reagimi i të tjerëve? Si e kanë perceptuar përvojën që iu treguat?
- » A jeni ndjerë e mbështetur apo e kritikuar? Pse? Si do e përshkruanit procesin e të kërkuarit ndihmë nga momenti i marrjes së vendimit deri në fund? Çfarë sfidash ka pasur në këtë proces?
- » A pati ndonjë shërbim që mundët të merrnit si një përgjigje e menjëhershme për situatën? Pse?
 - » Nëse po, çfarë shërbimi morët? A kishit informacion të mëparshëm për të?
 - » Si u ndjetë? Çfarë qëndrime pati nga vetë ofruesi/ja e shërbimit?
 - » Sa iu përgjigjën ato nevojave tuaja të momentit?
- » Çfarë do të vlerësonit më shumë nga eksperiencia e marrjes së ndihmës? Çfarë mund të ishte bërë më mirë? Çfarë sugjeronit për të përmirësuar marrjen e shërbimeve për të mbijetuarat/it e tjera/ë të abuzimit seksual?
- » Kush ishte momenti më i vështirë në gjithë këtë përvojë? Çfarë ka lënë gjurmë më shumë tek ju?

personaliteti, vlerat etj.)

- » Po në raport me punësimin, socializimin me të tjerët, marrëdhëniet me të afërmit, marrëdhëniet intime ose në fusha të tjera të jetës?
- » Bazuar në eksperiencën tuaj, cilin/cilat shërbime do veçonit si më të vlefshme/ndihmuese për ju? Pse?
- » Cilat kanë qenë zhgënjyese / dëmtuese më shumë se ndihmuese? Pse?
- » Çfarë shërbimesh merrni tani? Jeni e kënaqur prej tyre? Pse?
- » Çfarë shërbimesh të tjera do donit që të kishit?
- » Çfarë do donit të përmirësohej në shërbimet e ofruara nga strukturat shtetërore dhe ato jo-shtetërore? Si mund të përmirësoheshin shërbimet për të inkurajuar më shumë raportimin e abuzimeve dhe marrjen e ndihmës?
- » Si e përfytyroni të ardhmen tuaj?
- » Çfarë këshillash do i jepnit një personi tjetër që mund të jetë duke kaluar një përvojë të ngjashme në këtë moment? Njihni ndonjë person tjetër që është në këtë situatë?
- » A ka ndonjë pyetje tjetër që do të donit t'ju ishte drejtuar? Keni ndonjë pyetje tjetër për mua?

Faleminderit!

Seksioni 3. Jeta pas abuzimit seksual

- » Si ju ka ndryshuar jetën kjo përvojë? Çfarë ka ndryshuar tek ju? (shëndeti fizik, mendor,

DISKUTIM NË FOKUS GRUP

Gra dhe/ose burra

Analiza e situatës së dhunës seksuale në Shqipëri

Letër Informuese

Ky fokus grup po realizohet në kuadrin e një studimi për "Analizën e situatës për dhunën seksuale në Shqipëri", që po kryhet nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), i cili realizon vazhdimisht studime mbi tema të ndryshme që lidhen me gratë dhe çështjet e barazisë gjinore. Studimi është bërë në kuadrin e programit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim – SIDA. Do t'ju ishim mirënjohës/e nëse do t'i përgjigjeshit pyetjeve tona rreth opinionëve dhe përvojave tuaja lidhur me dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual, shkallën e përhapjes së tij në Shqipëri, mendimet rreth të mbijetuarave dhe abuzuesve, procesin e të kërkuarit ndihmë, si dhe sfidat pasi i ke mbijetuar dhunës.

Dëshirojmë t'ju sigurojmë se i gjithë informacioni që ne mbledhim do të ruhet me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Asnjë individ apo adresë e veçantë nuk do të mund të identifikohet në asnjë prej fazave të kërkimit/studimit. Pjesëmarrja juaj në studim është krejtësisht vullnetare dhe në çdo çast mund të ndiheni të lira/ë të mos t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara apo të tërhiqeni nga pjesëmarrja në studim.

Për moderatoren dhe mbajtësen e shënimeve

Zona: _____

Vendi: Urban ose rural _____

Data: _____

Përbërja e grupit:

Nr. i pjesëmarrësve: _____ prej të cilave vajza/gra _____

Shënime:

Detajet e pjesëmarrësve

Nr.	Gjinia	Mosha	Punësimi	Zonë urbane ose rurale	Arsimi
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					

Pyetjet për diskutim

1. Të kuptuarit e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual

- » Në këndvështrimin tuaj çfarë është dhunë seksuale? Po ngacmim seksual?
- » Kur ka qenë hera e parë që keni dëgjuar/jeni informuar mbi dhunën dhe ngacmimin seksual? Nga kush?
- » Ku jeni informuar/informoheni për dhunën ose ngacmimin seksual? A është e lehtë për të pasur akses në këtë lloj informacioni, pse?
- » Çfarë e bën një person më vulnerabil për të qenë viktimë e dhunës ose e ngacmimit seksual? Mund të na jepni disa shembuj? Çfarë

e bën një grua/vajzë ose burrë/djalë që të ndihet më i sigurt? (stereotipat, paragjykime për viktimën ose për abuzuesin)

- » Kujt ka të ngjarë t'i ndodhë më shumë? A ka karakteristika / sjellje / qëndrime etj., që mund ta bëjnë dikë më vulnerabil? Po më rezilient? Çfarë? Pse? (shiko për diferenca gjinore)
- » Çfarë e bën një person më të predispozuar për të qenë abuzues seksual? Pse?
- » Si mendoni, sa i përhapur është fenomeni i abuzimit seksual në Shqipëri? Po i ngacmimit seksual? Në cilat fusha të jetës është më i pranishëm?
- » Po në komunitetin tuaj / rrethin tuaj të njohurve, keni dëgjuar për eksperiencat të tilla? Çfarë?
- » A është përmirësuar apo përkeqësuar situata lidhur me dhunën apo abuzimin seksual gjatë viteve të fundit? Pse është Shqipëria/zonat specifike më të prekura/më pak të prekura nga ky fenomen?

2. Përvoja e dhunës seksuale ose e ngacmimit seksual

- » Pa përmendur emra personash, a njihni dikë që ka përjetuar dhunë seksuale ose ngacmim seksual në jetën e vetë? Nëse po, mund të na përshkruani se çfarë i ka ndodhur, me aq informacion sa keni?
- » Ku ndodh ngacmimi seksual? Po abuzimi seksual? A ka vende/hapësira specifike që mund të ndodh më shumë? Përse pikërisht aty?
- » Si jeni informuar për rastet që përmendet? Çfarë ka ndodhur më pas me këto vajza/gra (apo burra/djem)? Çfarë problemesh kanë pasur?
- » Si ka reaguar familja e tyre? A ka patur një reagim të ndryshëm mes grave dhe burrave në familje? Po komuniteti ku jetonin?
- » Çfarë mendoni ju për mënyrën e reagimit të tyre? Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

3. Kërkimi i ndihmës

- » Si mendoni, a ka gatishmëri për të kërkuar ndihmë në një situatë dhune/ngacmimi seksual? Pse?
- » Si dhe ku kërkojnë ndihmë vajzat/gratë ose djemtë/burrat në rastet kur ata ngacmohen ose dhunohen seksualisht? A ka diferenca? Pse?
- » Çfarë e bën më të vështirë/lehtë kërkimin e ndihmës për të? (marrëdhënie intime, marrëdhënie besimi me abuzuesit, zonë urbane rurale, mosha e saj, besimi tek institucionet etj.)
- » Duke menduar për rastet që përmendet më lart, si kanë reaguar institucionet/shërbimet kur ajo/ai ka denoncuar dhunën seksuale? Po ngacmimin seksual? A kanë marrë shërbimet e nevojshme/të duhura? Sa të kënaqura kanë qenë nga marrja e këtyre shërbimeve? Pse?
- » Sa informacion ndjeni se keni ju në lidhje me abuzimin seksual dhe ngacmimin? Kush janë më pak të informuar, pse?
- » Nëse do ju ndodhte diçka e ngjashme, si do e përballonit? A do kërkonit ndihmë apo jo? Pse?
- » Bazuar në historitë që njihni, si ka qenë e ardhmja e të mbijetuarave të dhunës seksuale? Cilat janë sfidat përtej kërkimit të ndihmës dhe adresimit të situatës së dhunës?
- » Cilat janë sfidat /barrierat në riintegrim për të mbijetuarat e dhunës seksuale?
- » Si mund të ndihmohen për t'i tejkalluar ato?
- » A ka ndonjë pyetje tjetër që do donit që të diskutonim?

Faleminderit për pjesëmarrjen!

DISKUTIM NË FOKUS GRUP

Përfaqësues të shoqërisë civile

Analiza e situatës së dhunës seksuale në Shqipëri

Letër Informuese

Ky fokus grup po realizohet në kuadrin e një studimi për "Analizën e situatës mbi dhunën seksuale në Shqipëri", që po kryhet nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), i cili realizon vazhdimisht studime mbi tema të ndryshme që lidhen me gratë dhe çështjet e barazisë gjinore. Studimi është bërë në kuadrin e programit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SIDA. Do t'ju ishëm mirënjohës/e nëse do t'i përgjigjeshit pyetjeve tona rreth opinionëve dhe përvojave tuaja lidhur me dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual, shkallën e përhapjes së tij në Shqipëri, mendimet rreth të mbijetuarave dhe abuzuesve, si dhe procesin e të kërkuarit ndihmë.

Dëshirojmë t'ju sigurojmë se i gjithë informacioni që ne mbledhim do të ruhet me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Asnjë individ apo adresë e veçantë nuk do të mund të identifikohet në asnjë prej fazave të kërkimit/studimit. Pjesëmarrja juaj në studim është krejtësisht vullnetare dhe në çdo çast mund të ndiheni të lirë të mos t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara apo të tërhiqeni nga pjesëmarrja në studim.

Për moderatoren dhe mbajtësen e shënimeve

Zona: _____

Vendi: Urban ose rural _____

Data: _____

Përbërja e grupit:

Nr. i pjesëmarrësve: _____ prej të cilave gra _____

Shënime:

Detajet e pjesëmarrësve

Nr.	Gjinia	Mosha	Punësimi/ Institucioni	Pozicioni i punës
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				

Pyetjet për diskutim

1. Të kuptuarit e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual

- » Në këndvështrimin tuaj çfarë konsiderohet në Shqipëri dhunë seksuale? Po ngacmim seksual? A ka ndonjë ndryshim në këtë mendim mes djemve/vajzave? Po mes zonave rurale dhe urbane?
- » Çfarë e bën një person më vulnerabil për të qenë viktimë e dhunës ose e ngacmimit seksual? Mund të na jepni disa shembuj? Çfarë e bën një grua/vajzë ose burrë/djalë që të ndihet më i sigurt? (stereotipat, paragjykimet për viktimën ose për abuzuesin)
- » Çfarë e bën një person më të predispozuar për të qenë abuzues seksual? Pse?

- » Si mendoni, sa i përhapur është fenomeni i abuzimit seksual në Shqipëri? Po i ngacmimit seksual? Në cilat fusha të jetës është më i pranishëm?
- » A është përmirësuar apo përkeqësuar gjatë viteve të fundit? Pse është Shqipëria/zonat specifike më të prekura/më pak të prekura nga ky fenomen?
- » Nëse keni informacion, sa është niveli i raportimit të dhunës seksuale ose ngacmimit seksual? Pse?

2. Përvoja e dhunës seksuale ose e ngacmimit seksual

- » Gjatë eksperiencës suaj, a keni hasur persona që kanë qenë viktime ose abuzues seksualë? Po të ngacmimit seksual? Nëse po, mund të na përshkruani se çfarë i ka ndodhur, me aq informacion sa keni?
- » Ku ndodh ngacmimi seksual? Po abuzimi seksual? A ka vende/hapësira specifike që mund të ndodh më shumë? Përse pikërisht aty?
- » A ka karakteristika / sjellje / qëndrime etj., që mund ta bëjnë dikë më vulnerabil? Po më rezilient? Çfarë? Pse? (shiko për diferenca gjinore)
- » Çfarë ka ndodhur më pas me këto vajza/gra (apo burra/djem)? Çfarë problemesh kanë pasur?
- » Si ka reaguar familja e tyre? A ka patur një reagim të ndryshëm mes grave dhe burrave në familje? Po komuniteti ku jetonin?
- » Çfarë mendoni ju për mënyrën e reagimit të tyre? Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

3. Kërkimi i ndihmës

- » Si dhe ku kërkojnë ndihmë vajzat/gratë ose djemtë/burrat në rastet kur ata ngacmohen ose dhunohen seksualisht?
- » Çfarë e bën më të vështirë/lehtë kërkimin e ndihmës për të? (marrëdhënie intime, marrëdhënie besimi me abuzuesit, zonë urbane rurale, mosha e saj, besimi tek institucionet etj.)

- » Duke menduar për rastet që përmendet më lartë, si kanë reaguar institucionet/shërbimet kur ajo ka denoncuar dhunën seksuale? Po ngacmimin seksual?
- » Sa të kënaqura kanë qenë nga marrja e këtyre shërbimeve? Pse po apo pse jo?
- » Si është e ardhmja e të mbijetuarave të dhunës seksuale? Cilat janë sfidat përtej kërkimit të ndihmës dhe adresimit të situatës së dhunës?
- » Cilat janë sfidat / barrierat në riintegrim për të mbijetuarat e dhunës seksuale?
- » Si mund të ndihmohen për t'i tejkaluar ato?

4. Kuadri ligjor, politik dhe shërbimet

- » Cilat janë ligjet/strategjitë ose planet e veprimit në nivel kombëtar dhe vendor që adresojnë çështjet e abuzimit seksual dhe ngacmimit?
- » C'nivel prioriteti ka për to në nivel qendror? Po në atë vendor?
- » Sa zbatohen këto? Si matet zbatimi i tyre?
- » A mendoni se këto adresojnë të gjitha çështjet/ nevojat që lidhen me ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale? Nëse po, si? Nëse jo, cilat janë sfidat/boshllëqet dhe si mund të plotësohen?
- » Duke u bazuar në eksperiencën tuaj, cilat janë shërbimet ekzistuese për të mbijetuarat e dhunës ose ngacmimit seksual? A janë të mjaftueshme? Pse?
- » Si mund të përmirësohen shërbimet ekzistuese? Nëse ka nevojë për shërbime të reja, cilat janë ato?
- » A ka ndonjë pyetje tjetër që do donit që të diskutonim?

Faleminderit për pjesëmarrjen!